

TJETÄR*

2025

KULTURÄ

PERMBAJTJA

TJETER 2025 KULTURE

- 01 **Taravitë në Fushë Kosovë: Lypsarë e pasanikë, shqiptarë e ashkali bashkë**
- 02 **“Martesa” dekonstrukturon normat shoqërore dhe eksplorimin e identitetit**
- 03 **“Të turpëruarit”, një pasqyrë e thyer e identitetit modern**
- 04 **Libri si zbukurim, jo për lexim: Librashitësit në Prishtinë të zhgënjyer**
- 05 **“Hapat e parë në Kamp” – A po i njihni këta fëmijë?!**
- 06 **“Testament”: Portrete që thyejnë stereotipe”**
- 07 **“Kufiri – Tragjedia përtej vijës së heshtjes”**
- 08 **“Deadline”: Gazeta si art skenik në epokën pa fjalë të shtypur**
- 09 **Mos këqyrni seri, këqyreni këtë seri: Unbelievable**
- 10 **Qytetar-katunar: Historia e gërditshme e ndasisë mes kosovarëve**
- 11 **Ulpiana është shumë më INTERESANTE se që keni mendu**
- 12 **Fëmijët në Hardh Fest: midis përgjegjësisë së munguar dhe dhunës së heshtur kulturore**
- 13 **Krijimet ekstreme dhe turbulluese të László Krasznahorkai, fituesit të Nobelit 2025**
- 14 **Filmi “ERA”: Shikuesi torturohet si një i burgosur në Guantanamo**



TARAVITË NË FUSHË KOSOVË: LYPSARË E PASANIKË, SHQIPTARË E ASHKALI BASHKË

8 Mars, 2025 - 11:36

tjeter.net/taravite-ne-fushe-kosove-lypsare-e-pasanike-shqiptare-e-ashkali-bashke/

Rruga deri te xhamia ishte herë zhavorr, herë lloç e herë asfalt. Në të djathtë dukej një deponi e madhe bërlloku. Në të majtë shfaqeshin kohë pas kohe do shtëpi të vogla njëkatëshe me oborre të ndreqta mirë. Në të katër anët kishte banesa tetë-nëntë katëshe pa kusur. Terr. Ama jo aq terr sa me zhdukë shëmtinë e miksit të urbanes dhe rurales që karakterizon Fushë Kosovën.

Në ecje e sipër nëpër atë rrugicë të shfaqet oborri i mbuluar me bërllok i një shtëpie të lënë pas dore që ndriçej prej një reflektori. Pse me u ndriçu bërlloku, o hej? – e pyet veten. Por, pastaj e kupton se ai reflektor qëllimin e kishte me i orientu njerëzit kah rruga e zotit: menjëherë më pas të del para syve xhamia, objekti i madh me përplot drita si me qenë kasino gjigante e Las Vegasit.

S'është fort zor me u kuptu sesa keq e ka punën shoqëria jonë. Mjafton me dalë nëpër kafeteri e me i dëgju se çka flasin njerëzit me njëri-tjetrin. Hallexhinj me sens të pabesueshëm megalomanie. Badihavxhinj me tendenca perverse përulëse e përçmuese. Punëtorë të zvetënuar prej preokupimit për status social. Parkingje të shëmtuara të mbushura me vetura të bukura. Çehre të prishta e gojë të liga.

E midis kësaj katrahure vulgare vlerash – midis qytetit me katrahurën më vulgare urbane në Kosovë – ndodheshin këta myslimanë në pritje me i falë taravitë.

S'jam mysliman, por e pranoj se njerëzit më të drejtë që i njoh në shoqërinë tonë janë myslimanët e devotshëm. S'pajtohem me vlerat që kanë – përveç që s'e besoj atë që e besojnë – por ashiqare mes tyre ekziston një farë imuniteti më i lartë për të këqijat shoqërore me të cilat përballemi.

Ajo çka po shihja në oborrin e xhamisë s'ishte kushedi çfarë mrekullie. Ishte diçka e zakonit për një natë ramazani. Fytyra të qeshura që e kishin heqë prej vetes anonimitetin e animozitetin shoqëror. Kishte gra e burra. Kishte shqiptarë, ashkali, egjiptianë – që e vizatonin natyrshëm gati gjysmën e flamurit të Kosovës. Kishte pasanikë e lypsarë. Ishte një përbashkësi që e kemi përzënë tash e sa kohë nga çfarëdo mjedisi tjetër ku jetojmë.

E vetmja mundësi me e pa bashkë një pasanik me një lypës është kafeteria e lagjes, me të parin që i ulur mendjemadhësisht pi diçka dhe të dytin që me përulje i kërkon lëmoshë.

Në xhami, i shihje bashkë nën një çati. Ishin të barabartë para Allahut. S'kishte dikush vlerë më të madhe shoqërore se tjetri.

Nëse për shumicën prej nesh barazia është veç një fjalë goje që e merr era, ose që e harron koha nëpër statute Facebook-u, në xhami kishte bile diçka reale. E ma merr mendja se po lëngojmë për 'bile diçka'.

Rrjetet sociale po na e prishin edhe përbashkësinë më elementare mes nesh, atë të species. Atë lloj përbashkësie që na thotë: jemi njerëz, në fund të fundit. Dallimet mes nesh – sociale, politike, kulturore, ekonomike – po përjetohe si ekzistenciale. Shumica dërmuese e njerëzve që shohim në Facebook s'arrijnë me respektu as dinjitetin njerëzor të njëri-tjetrit. Sepse, besojnë veç pasivisht te dinjiteti njerëzor. E besojnë vetëm kur iu cenohet atyre apo të afërmeve.

Shoqëria jonë është në shpërbërje. Në çintegrim e sipër. Ma merr mendja se kemi çka me mësu prej teravive e prej pesëvaktive. Kemi çka me mësu prej njëri-tjetrit.



“MARTESA” DEKONSTRUKTURON NORMAT SHOQËRORE DHE EKSPLORIMIN E IDENTITETIT

15 Mars, 2025 - 13:06

tjeter.net/martesa-dekonstrukturon-normat-shoqerore-dhe-eksplorimin-e-identitetit/

Nënshtrimi, frika, autoritarizmi dhe pushteti i pakontestuar duken se janë elemente kyçe që formësojnë botën e kësaj drame, duke e bërë atë një rrëfim jo vetëm për individët, por edhe për mekanizmat e kontrollit që shtrihen në nivele më të larta shoqërore.

Duke qenë në grevë për më shumë se tre muaj TKK-ja, jo që nuk ishte e zhvilluar asnjë aktivitet, por nisur nga komunikata e tyre edhe festivali “Moisiu” i cili do të duhej të mbahej në nëntor ishte anuluar. Festivali ishte paraparë të mbahej nga data 20 deri më 27 nëntor të vitit të kaluar në Prishtinë, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Shqipërisë, Teatrin Shqiptar të Maqedonisë dhe Teatrin Kombëtar të Kosovës. Edhe drama “Martesa” ishte një reprizë, premiera e saj ishte dhënë më 20 shtator të vitit 2024.

Shfaqja “Martesa” është bazuar në dramën “The Marriage” e shkruar nga Witold Gombrowicz, nën adaptimin dhe regjinë e Norbert Rakowskit dhe luajtur nga: Armend Smajli, Shkëlzen Veseli, Ylber Bardhi, Mensur Safqiu, Sheqerie Buçaj, Era Balaj dhe Adhurim Demi.

Drama “Martesa” duket se ndërton një narrativë mbi pasojat dhe traumat e luftës, e cila i vë në personazhet përballë sfidave psikologjike e shoqërore. Hyrja dhe dalja e karaktereve nga një derë në tjetrën mund të përçojë mesazhe si, kalimin nga një realitet në një tjetër, apo si diçka mes së shkuarës dhe së tashmes.

Skena e cila zhvendoset herë në një vend e herë në një tjetër, krijon përshtypjen se ngjarjet po zhvillohen në periudha të ndryshme kohore. Kjo lojë me kohën e hapësirën e bën dramën të përjetueshme në mënyrë të veçantë, duke e thelluar rrëfimin dhe intensitetin emocional. Metafora e përdorimit të “ gishtit ” shpeshherë mund të ketë një simbolikë të dyfishtë. Nga njëra anë, mund të jetë një referencë e drejtpërdrejtë ndaj përdorimit të armës, duke paraqitur një realitet të mbushur me dhunë dhe tension. Nga ana tjetër, mund të përfaqësojë edhe një metaforë më të gjerë mbi pushtetin, kontrollin dhe aktin e vendimmarrjes.

Konservatorizmi paraqitet përmes aranzhimit të martesës së Henrit, ku ai përpiqet të krijojë një rend të ri përmes institucionit të martesës. Megjithatë, ky rend shndërrohet në një farsë, një manifestim i absurdit etit që shpërbën çdo iluzion për stabilitet dhe vlera të vërteta. Edhe autoritarizmi, si një fenomen i pranishëm në shfaqje, nuk kufizohet vetëm brenda dinamikave familjare, por mund të shihet edhe si një pasqyrë e një realiteti më të gjerë shoqëror e politik.

Armend Smajli personazhi kryesor i kësaj drame ka thënë për magazinën TJETËR* se, nëse je pjesë e një vendi ose shoqërie, ose shteti që ka kaluar një periudhë të luftës dhe nëse lexon atë tekst detyrimisht ka për ta kujtuar luftën.

“ Kjo nuk do të thotë se dikush tjetër mund të lexojë dhe të gjejë diçka tjetër, se drama dhe autori merret me shumë dimensione të elementeve jetësore, po për mua dhe për ne, ndoshta për shumicën kur e kemi lexuar, në një mënyrë ose tjetër të kthen te ajo pikë, te ato kujtime, periudha e luftës dhe traumat e saj,” – ka thënë Smajli.

Ai ka thënë se hyrja nga një derë dhe dalja nga një derë tjetër mund të interpretohet në shumë forma, ai është leximi konceptual i regjisorit, më shumë ka të bëjë me disa labirinte që të japë jeta, që ndonjëherë janë absurde.

“H yjmë diku dhe dalim diku është njëfarë kërkimi i gjetjes së diçkaje, nganjëherë edhe disa pengje që na mbesin në jetë edhe ndoshta një lloj korridori, njëfarë labirinti i jetës që jemi në kërkim të diçkaje, të disa pengjeve. Një prej interpretimeve mund të jetë edhe kjo, por është një dramë, por edhe si lojë akt o reske konceptualisht i përket zhanrit jo komplet konvencional, sa që shumë interpretime mund të përkthehen në disa forma prej audiencës, një shfaqje shumë dimensionale,” ka thënë Smajli.

Ai ka thënë se ambicia e njerëzore në fund të fundit janë universale. “ E dhe ambicia politike, ambicia për fron, për pushtet edhe qëllimet, mjetet për të ardhur në atë pushtet janë universale dhe kudo që inskenohen është gjuha e njëjtë. Edhe në jemi pjesë e universales”, ka thënë Smajli

Smajli – aktori kryesor i shfaqjes – ka shtuar se kur e lexon dramën e cila është shkruar pas Luftës së Dytë Botërore edhe kupto het që ajo shoqëria patriarkale, ato normat morale që kanë qenë janë edhe sot prezente tek të gjitha shoqëritë, tek të gjitha religjionet .

“ Kjo vepër është shkruar në Poloni , por flet shumë për realitetin e sotëm shqiptar, si një babë shqiptar që i flet vajzës sonë me një qasje shumë konservative. Por kthehem aty që disa norma i kemi krijuar si njerëz, nuk i kemi krijuar vetëm ne, por disa i kanë tejkaluar e tene janë më të theksuara. Gjëra të cilat kur i ka theksuar Gombrowicz-i për shoqërinë polake ndoshta sot s'janë evidente aq shumë, por e vëren patriarkalizmin , atë imponimin, atë arsyen, ato normat morale , kodet morale që i kemi krijuar ne si njerëz , e pastaj ato shpërndahen përmes religjionit dhe elementeve të tjera shoqërore, ” – ka thënë Armend Smajli.

Përmes absurdit dhe surrelizmit, kjo shfaqje na orienton mbi mënyrën se si krijohet një rend në një botë kaotike, duke na lënë në kufijtë mes një fati të paracaktuar dhe një loje të pambaruar dhe me maska.



“TË TURPËRUARIT”, NJË PASQYRË E THYER E IDENTITETIT MODERN

22 Mars, 2025 - 14:18

tjeter.net/te-turperuarit-nje-pasqyre-e-thyer-e-identitetit-modern/

Shfaqja teatrale "Të turpëruarit" është një pasqyrë e një shoqërie në kontradiktë me vetveten. Është një dramë që nuk ofron përgjigje të lehta, por që e zhvesh njeriun modern nga iluzionet e barazisë, tolerancës dhe progresit.

Më 17 mars në orën 20:00, në Amfiteatrin e Teatrit Kombëtar të Kosovës është shfaqur premiera mysafire "Të turpëruarit", në bashkëpunim mes artistëve nga Prishtina dhe Tirana. Regjisor: Altin Basha; aktorë: Adrian Morina, Blerta Sylja Surroi, Kushtrim Sheremeti, Aurita Agushi dhe Endrit Ahmetaj.

"Të turpëruarit" është një dramë që eksploron konfliktet e identitetit, religjionit, racës dhe klasës në një shoqëri pas 11 shtatorit të vitit 2001, ku kufijtë ndërmjet vetidentifikimit dhe perceptimit shoqëror janë gjithnjë e më të mjegullt. Ngjarja zhvillohet në një hapësirë intime, një dhomë, ku tensionet globale shndërrohen në drama personale, ku historia, ideologjitë dhe dëshirat përplasen në një darkë të vetme.

Në shprehje vjen edhe racizmi, dhe se si në Amerikë nuk është më thjesht verbal apo institucional, por shpesh fshihet pas gjuhës liberale dhe sipërfaqësisht të përfshirë. Edhe brenda rrethit të afërt të personazheve – që përfaqësojnë një Amerikë të arsimuar dhe artistike – paragjykimet dalin në sipërfaqe kur tensioni rritet. Gjuha e tyre, edhe kur është intelektuale, mbart një qasje kolonialiste ndaj "tjetrit".

Si temë feja islame, nuk trajtohet në mënyrë apologetike, por përballet si një realitet kompleks – për dikë burim krenarie, për dikë tjetër burim turpi.

Altin Basha, regjisor i dramës, ka thënë se kjo vepër provokon një diksutim, provokon një refleksion mbi forcën e religjionit, mbi sfidën që paraqitet para shoqërive dhe mënyrën se si perceptohet, mbi historinë e religjionit, mbi marrëdhëniet e njeriut më mënyrën sesi ai mund të ndryshojë, ose të jetë prezent si një vlerë përmbajtësore e njerëzimit në historinë e tij, kështu që shfaqja i prek të gjitha këto diskutime me shumë elegancë, me shumë mjeshtri, me shumë kulturë edhe sigurisht krijon para publikut një panoramë, një moment interesant informacioni, por edhe reflektim emocional dhe filozofik rreth këtyre temave.

"Ne mbetemi në mes një diskutimi historik në këtë dimension, sigurisht kjo nuk është shumë prezent në teatër dhe kjo e bën këtë vepër shumë specifike. Madje prej vitit kur është botuar është shfaqur në skenat botërore dhe pikërisht ka provokuar këto momente. Mendoj është një diskutim që mes nesh e kemi, në shoqëritë tona e kemi, mbi ato që i përmenda më parë dhe besoj që krijon diskutime, krijon refleksione për publikun shqiptar. Edhe sigurisht mbi çështjen e identitetit me mënyrën se si perceptohet te religjioni dhe marrëdhëniet me identitetin dhe shumë elemente të tjerë," ka thënë Basha për magazinën Tjetër.

Adrian Morina ka thënë se regjisori bashkë me ekipin, me pajtimin e të gjithëve kanë vendosur për emrin "të turpëruarit", meqenëse në një formë ose në një tjetër, të gjitha personazhet që janë aty janë të turpëruar.

"Po flasim për një shfaqje e cila flet përmbi përkatësinë fetare, flet për identitetin e njerëzve, por në anën tjetër nuk është tekst që komunikon vetëm me një popull ose me një komb, është tekst të cilin nuk ke nevojë as ta kontekstualizosh dhe të provosh ta bësh më të afërt me publikun," ka thënë Morina.

Ai ka thënë se drama i flet secilës shoqëri me problemet të cilat i ka edhe më tutje.

"Fatkeqësisht, ne e dimë për shqiptarët e Greqisë se si e kanë fshehur identitetin duke dashur që të fitojnë letrat në Greqi dhe kanë ndërruar identitet me emra, me mbiemra, pra është dashur ta mohojnë identitetin e tyre për t'u bërë pjesë e një shoqërie," ka thënë Morina.

Tutje ai ka thënë se kjo shfaqje është dhënë shumë vite pas sulmeve të 11 shtatorit, pra një shfaqje ku pas këtyre ngjarjeve popullata myslimane, jo vetëm në Amerikë, por kudo në botë është sulmuar dhe paragjykuar fuqishëm, sa që njerëzit janë detyruar t'i ndërrojnë identitetet e tyre ashtu siç e kemi personazhin e Amirit, i cili vendos të ndërrojë gjithçka, thjesht për të arritur në institucionet ku ai synon të jetojë e të punojë, që më vonë i kthehet në bumerang dhe në fund ai ndihet i turpëruar edhe për atë që është, edhe për atë që nuk është.

“Autori flet për të gjitha llojet e paragjytimeve dhe të turpërimit, por tema qendrore e kësaj drame është identiteti religjioz sepse lufta e civilizime po vazhdon edhe sot në emër të feve, por po them se të gjitha këto vlera bien poshtë nëse kthehemi vetëm pak mbrapa dhe e shohim se kush kemi qenë ne dhe cilat kanë qenë veprat tona, e kam fjalën për njerëzimin. Njerëzit e shtypur krijojnë njerëz të shtypur. Ky zingjir i skllavërimit nuk po ndalon, dhe nuk është lehtë me çrrënjës këtë marifet,” – ka thënë Morina për magazinën Tjetër.

Kjo shfaqje teatrale është ftesë për të reflektuar se sa të thella janë ndarjet që i kemi fshehur pas perdeve të korrektesës politike dhe sa e vështirë është të jesh i ndershëm ndaj vetvetes në një botë ku çdo identitet është një pazar politik.



LIBRI SI ZBUKURIM, JO PËR LEXIM: LIBRASHITËSIT NË PRISHTINË TË ZHGËNJYER

24 Mars, 2025 - 16:33

tjeter.net/libri-si-zbukurim-jo-per-lexim-librashitesit-ne-prishtine-te-zhgenjyer/

Mu në qendër të qytetit aty ku ka lëvizje të pandërprerë të njerëzve, libraritë-kioska mbushur me libra, por jo me lexues. Këto hapësira të vogla të mbushura me libra, mezi arrijnë të ndonjë lexues. Kalimtarët mund të ndalojnë për një moment, të hedhin një sy, por rrallëherë dikush hyn për të blerë.

Një kafe-bar pothuajse ngjitur dhe rrethuar me libraritë-kioska është i mbushur me klientë. Mes tyre, nuk dallohet asnjë qytetar me një libër në dorë, kurse në anën tjetër nuk i ndajnë sytë nga ekranet e telefonave.

Kjo pamje tashmë shumë e zakonshme dhe e përditshme është një pasqyrë e gjendjes së leximit në shoqërinë tonë. Nuk ka nevojë të intervistohen librashitësit për të kuptuar se sa pak lexohet. Libraritë bosh dhe kafenetë plot flasin vetë.

Fokusi nuk është vetëm tek të lexuarit, por edhe tek ata autorë të cilët lexohen më shumë nga ata pak lexues që janë, dhe sa kanë përkrahje institucionale librashitësit e këtyre mini-librarive.

Florim Beqiri dhe Mirsad Krasnqi janë dy nga shumë librashitësit e librarive-kioska që shqetësimin më të madh e kanë të lexuesit. Ata thonë se lexohet shumë pak, pavarësisht se librat që ata shesin janë libra të përdorura dhe çmimet e tyre janë shumica të arsyeshme, ato shume pak arrijnë deri të lexuesi.

“Është e çuditshme se si lexohet kaq pak, kurse kemi kaq shume universitete publike e kolegje private dhe aty shkohet për të studiuar, aty shkohet për të studiuar, por siç shihet studim ka pak. Kjo po tregohet edhe me rezultatet e PISA-s,” – ka thënë Florim Beqiri për magazinën Tjetër.

Beqiri ka thënë se lexuesit tanë e ndjekin një trend dhe janë të pirur të lexojnë nobelistë ose shkrimtarë që kanë shitur me miliona libra, që do të thotë se shkrimtarët e huaj janë ata që lexohen më shumë.

“Kjo është për arsye se ndikohen nga rrjetet sociale duke i përcjellë ato. Shkrimtarët më të kërkuar janë klasikët e huaj të përkthyer në gjuhën amtare, si Dostojevski, Pushkini, Niçe por edhe autorë si, Hermann Hesse, Umberto Eco e të tjerë.”

Ai më tutje ka shtuar se shkrimtari shqiptarë Ismail Kadare mbetet i pakonkurrencë, librat e tij që lexohen më shumë janë: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kështjella”, “Kush e solli Doruntinën”, “Kronikë në gurë”, kurse pas tij radhiten Fatos Kongoli e e Fatos Arapi. Sa i përket shkrimtarëve nga Kosova Ag Apolloni është më i lexuari.

“Një pjesë të qytetarëve kushtet ekonomike janë ato që ua determinojnë leximin e librave, ato janë të shtrenjta, edhe pse në libraritë tona çmimet mundohemi t'i kemi të arsyeshme, duke pasur parasysh se kemi libra të përdorur në shitje .

Ai më tutje shton se përveç letërsisë librat të cilat lexohen janë edhe librat e fushës së psikologjisë, kryesisht ato libra që njihen si libra të psikologjisë pozitive ose parapsikologji dhe historia.

Beqiri ka thënë se përkrahje modeste kemi nga Komuna e Prishtinës, por edhe nga Mnistria e Kulturës, institucione të cilat i kanë liruar nga tatimi.

TJETËR është një faqe që funksionon në baza vullnetare. Mbështet punën tonë duke pëlqyer faqen tonë në Facebook (KËTU) dhe kanal tonë në YouTube (KËTU).

Mirsad Krasniqi, i cili ka qenë edhe punëtor i “Rilindjes” ka thënë se kryesisht mbizotërojnë autorë të huaj, letërsia e huaj e përkthyer në gjuhën shqipe dhe sidomos klasikët, të cilët ende dominojnë në krahasim me letërsinë tonë.

“Në përgjithësi dominon letërsia ruse, pasuar nga ajo frënge dhe gjermane. Prijnë Dostojevski dhe Tolstoi, ndërsa nga letërsia frënge Balzaku, nga ajo gjermane Hesse dhe Heine që kërkohen nga lexuesit e mirëfilltë”, ka thënë Krasniqi për magazinën Tjetër.

Ai më tutje ka shtuar se sa i përket autorëve të cilët e fitojnë çmimin Nobel, ata lexohen për një kohë të shkurtër, njerëzit janë të interesuar ta dinë se kush fitoi këtë çmim dhe ditëve të para kërkohen ata autorë dhe veprat e tyre, por lexuesit prapë i rikthehen autorëve të cekur më lart, sepse ka shumë autorë cilësorë të cilët nuk kanë fituar këtë çmim .

“Kur jemi te autorët shqiptarë mbizotëron Kadreja dhe Agolli, kurse nga autorët shqiptarë nga Kosova lexohen Ali Podrimja, Rexhp Qosja, Zejnullah Rrahmani, Ag Apolloni, Veli Karahoda, Ballsor Hoxha e shkrimtarë të tjerë” , ka thënë Krasniqi.

Ai ka thënë se përveç Komunës së Prishtinës nuk ka përkrahje nga asnjë institucion tjetër. Nga ky institucion nuk kërkohet të paguhet tatim, hapësira publike e shfrytëzuar dhe as rryma e cila mund të shfrytëzohet gjatë dimrit.

“Mirëpo më shumë më shqetëson fakti se lexohet shumë pak . Pavarësisht se çmimet e librave mundohemi t’i kemi reale, prapë se prapë librat shiten pak, lexohet pak. Te rinjtë më shumë parapëlqejnë të rrinë në telefon dhe të shikojnë emisione pa vlera që transmetohen në televizione se sa librat” , ka thënë ai.

“Apeli im u drejtohet lexuesve, ata që janë të hamundur t’i kthehen sa më shumë leximit, sepse ka shumë libra të mirë edhe nga autorët tanë, por edhe nga letërsia botërore. Tek e fundit pak ka rëndësi se çfarë lexojnë, vetëm lë të lexojnë ” , është shprehur Krasniqi.

Libri, dikur mjeti kryesor i formimit intelektual, sot konkurren me rrjetet sociale, videot e shkurtra dhe përmbajtjet e lehta që kërkojnë pak përqendrim. E kjo duket të jetë përzgjedhja e shumicës së qytetarëve.

TJETËR është një faqe që funksionon në baza vullnetare. Mbështet punën tonë duke pëlqyer faqen tonë në Facebook (KËTU) dhe kanalin tonë në YouTube (KËTU).



“HAPAT E PARË NË KAMP” – A PO I NJIHNI KËTA FËMIJË?!

29 Mars, 2025 - 13:32

tjeter.net/hapat-e-pare-ne-kamp-a-po-i-njihni-keta-femije/

Në Open Art Gallery, ku drita ndalet me respekt mbi secilën fotografi, është hapur ekspozita “ Hapat e parë në Kamp ” – një rrëfim i thellë vizual mbi një nga momentet më të ndjeshme të ekzistencës shqiptare: eksodi i vitit 1999. Kjo ekspozitë sjell në qendër të saj fëmijët shqiptarë të Kosovës, nga një moshë nën një vjeç e deri 4 – 5 vjeçar, të cilët, pa e ditur ende ku janë, janë fotografuar në kampin e refugjatëve në Çegran, gjatë luftës së Kosovës.

Fotografitë e ekspozitës janë kapur nga fotografi Osman Demiri i cili ishte i pranishëm në kamp dhe përtej dokumentimit të një krize humanitare, ka ditur ta ndalojë kohën në çaste intime të jetës. Një foshnje që akoma nuk ka filluar hapat e parë qëndron mbështetur mbi këmbët e shtrira të nënës së tij, një djalosh që ka mbështetur duart mbi disa tela që duket sikur të ishte në kampet e përqendrimit të Luftës së Dytë Botërore – janë jo vetëm imazhe, por dëshmi të gjalla të shpirtit të një populli në ikje.

Titulli “ Hapat e parë në Kamp ” bart në vete një simbolikë të thellë. Nuk është fjala vetëm për hapat fizikë të fëmijëve që mësojnë të ecin; është fjala për hapat e parë të një brezi që u lind mes telave me gjemba, por që bartte në vete të ardhmen e një vendi. Është kujtesë e asaj që nuk duhet harruar, por edhe një thirrje për të parë me sy të qartë të kaluarën, për të ndërtuar një të ardhme më të drejtë.

Deklaratat e Osman Demirit dhe Burim Myftiut për magazinën TJETËR hedhin dritë mbi një fragment të dhimbshëm, por thellësisht njerëzor të historisë sonë kolektive – përvojën e fëmijëve të refugjatëve shqiptarë në kampin e Çegranit më 1999. Përmes fotografisë si dëshmi e kohës dhe ndjeshmërisë artistike, Demiri ka përjetësuar momente të trishta, por edhe të mbushura me shpresë, duke i dhënë zë një brezi që përjetoi luftën pa e kuptuar plotësisht, por që mbeti shenjë e gjallë e asaj tragjedie.

Osman Demiri për magazinën TJETËR ka thënë se për të ka qenë një prioritet i jashtëzakonshëm i rrallë shumë, shumë rrëqethës dhe nuk ka ditur se si mund ta përshkruaj me fjalë. Më tutje ka shtuar se për të fjala “ refugjatë ka qenë e ashpër, ka qenë e huaj, duke e ditur se populli i Kosovës dhe i Maqedonisë janë faktikisht një popull, shumë të familjarizuar dhe nuk ka qenë e mundur të quhen asnjëherë refugjatë,”

Këta janë fëmijë që sapo kishin nisur të hedhin hapat e parë në jetë – por fatkeqësisht, në vend të tapetit të butë të shtëpisë apo oborrit të ngrohtë, ata ecën mbi zhavorr kampi, mes tendave të improvizuara dhe syve të lodhur të prindërve të përhumbur nga ankthi.

TJETËR është një faqe që funksionon në baza vullnetare. Mbështet punën tonë duke pëlqyer faqen tonë në Facebook (KËTU) dhe kanalin tonë në YouTube (KËTU).

“Mirëpo sidoqoftë ata rolin e refugjatëve e kanë pasur, për arsye se kanë ardhur në një vend që për fëmijët ka qenë i panjohur, që nuk e dinin se ku gjenden dhe çka është duke ndodhur përreth tyre, dhe ajo ka qenë sfida më e madhe. Mirëpo në anën tjetër ka qenë edhe shpresa e prindërve të tyre të cilët e kanë parë një dritë në fund të tunelit sepse nuk dihej se kur do të mbarojë lufta, mirëpo këta sytë i kishin të fëmijët,” ka thënë Demiri.

Në çdo fotografi shfaqet diçka që nuk mund ta shuajë as mërgimi e as trauma: lojërat e natyrshme, pafajësia e lindur, dhe një buzëqeshje e cila, ndonëse e brishtë, ngrihet mbi tragjedinë si një akt i qëndresës së pastër njerëzore.

Ai ka thënë se shumë e vështirë për të ka qenë të bëhet përzgjedhja e fotografive dhe ta gjendet një buzëqeshje, një shikim, sepse të gjithë ishin të trishtuar dhe ai është munduar që prej asaj të keqeje dhe luftës së Kosovës të nxjerr diçka të mirë, diçka pozitive. Demiri shtoi se ishte përqendruar te fëmijët dhe të nxjerr atë më të mirën, më të bukurën.

“Unë mendoj se këta fëmijë duhet të jenë diku të suksesshëm për vetë faktin se kanë përjetuar këtë krahurë. Dhe kjo ka qenë një shkollë, edhe pse këta fëmijë të vegjël atëherë nuk e mbajnë mend, por ata të moshës 3-4 vjeçare me siguri e mbajnë mend dhe unë uroj dhe shpresoj se këta janë të suksesshëm nëpër botë ose në Kosovë”, ka thënë Demiri.

Ai ka shtuar se nuk ka pasur rast të takojë asnjë nga këta fëmijë që janë pjesë e fotografive dhe ekspozitës, por ndoshta i shohin fotografitë të afërmit e tyre dhe ndoshta do të ketë rastin edhe të takojë ndonjë prej tyre.

Burim Myftiu ka thënë për magazinën TJETËR se kjo është një përmbledhje e fotografive e fëmijëve të kampit të Çegranit të vitit 1999, ku ata ishin refugjatë së bashku me familjet e tyre është një dëshmi e kohës, është një dëshmi krimi të cilën Serbia bëri me popullatën e Kosovës.

TJETËR është një faqe që funksionon në baza vullnetare. Mbështet punën tonë duke pëlqyer faqen tonë në Facebook (KËTU) dhe kanalin tonë në YouTube (KËTU).

“Kjo përmbledhje është një vepër arti në çdo aspekt, duke i parë të gjitha këto se si i ka zënë Osmani, i ka regjistruar ato para 25 vjetësh dhe tani ekspozon një pjesë të vogël të përmbledhjes së tij, prej mijëra fotografive që i ka bërë gjatë luftës”, ka thënë Myftiu.

Myftiu ka shtuar se Demri ka bërë një selektim të disa prej atyre fotografive dhe i ka ekspozuar në një përmbledhje shumë të bukur artistike. Më tutje Myftiu ka thënë se kjo ka edhe vlerë historike, sepse është dëshmi e kohës, është dëshmi e shkatërrimeve, luftës, djegieve, dhunimeve, eksodit dhe gjitha atyre që përjetoi ky popull në kurrizin e vet prej pushtuesit serb.

Për Osmanin ka thënë se ai u integrua aty së bashku me fëmijët dhe u bë i padukshëm që të kapë atë spontanitetin e fëmijëve, karakterin e tyre, momentet e lojës. Ai e zuri atë karakterin e fëmijëve të cilët, pas gjithë atyre vuajtjeve nuk ishin të vetëdijshëm se çfarë ndodhte, mirëpo çdo njëri prej tyre e dinte se është fjala për një luftë, për një tmerr, për një humbje.

“Osmani përdori teknikën e portretizimit të karaktereve, jo të personit. Ai thellë fut në portret me intuitën e tij dhe bëri këtë projekt shumë të vlefshëm fotografike. Fotografitë e tij flasin vetë dhe nuk ka hapësirës për komente shtesë. Unë jam i sigurt që kudo nëpër botë, kudo që të ekspozohen këto fotografi do të ngjallin emocione”, ka shtuar fotografi Burim Myftiu.

Ky projekt fotografik nuk është vetëm një vepër arti, por edhe një testament vizual i së kaluarës sonë të afërt – një kujtesë për plagët, vuajtjet dhe dinjitetin e një populli të ndarë dhunshëm nga jeta e tij e përditshme. Ekspozita nuk kërkon të zgjojë mëshirë, por ndërgjegje. Nuk shfrytëzon dhimbjen, por e nderon atë. Sepse në fund të fundit, është një përkujtim se edhe në mes të shkatërrimit, jeta gjen mënyrën e saj për të filluar.

TJETËR është një faqe që funksionon në baza vullnetare. Mbështet punën tonë duke pëlqyer faqen tonë në Facebook (KËTU) dhe kanalin tonë në YouTube (KËTU).



“TESTAMENT”: PORTRETE QË THYEJNË STEREOTIPE”

5 Prill, 2025 - 12:21

tjeter.net/testament-portrete-qe-thyejne-steretipe/

Ekspozita “ Testament ”, e ndërtuar mbi portretet dhe dëshmitë jetësore të njëzet profesionistëve nga minoritetet rom, ashkali dhe egjiptian, përfaqëson më shumë se një shfaqje vizuale, ajo është një akt afirmimi, një gjest i thellë kundër harresës dhe një sfidë ndaj stereotipeve që prej dekadash rëndojnë mbi këto komunitete.

Nën syrin e mprehtë të fotografit Arben Llapashtica dhe nën kujdesin kuratorial të Eliza Hoxhës, kjo ekspozitë ngrihet si një testament i gjallë i talentit, përkushtimit dhe rezistencës.

Titulli i saj, “Testament”, nuk është zgjedhur rastësisht. Ai buron nga poezia me të njëjtin emër e poetit Kujtim Paqaku, një reflektim poetik që i jep zë historisë së përjashtimit, dhimbjes së trashëguar, por edhe krenarisë dhe dinjitetit që i ka mbijetuar kohës. Vargjet e tij shërbejnë si themel shpirtëror i ekspozitës, duke e kthyer hapësirën e galerisë “Qahili” në një altar të kujtesës kolektive dhe aspiratës për barazi.

Portretet janë realizuar në ambientet e përditshme të punës së protagonistëve, duke nxjerrë në pah jo vetëm personalitetin e tyre, por edhe dinamikën e jetës që ata ndërtojnë përtej paragjyqimeve. Secila fotografi është një rrëfim, një dëshmi e potencialit njerëzor që lulëzon kur i jepet hapësirë dhe dinjitet.

Isak Skenderi – drejtor i organizatës “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve” – ka thënë se kjo ekspozitë është synimi, qëllimi, rruga ku duhet shkuar, Kosova e cila këtyre njerëzve pavarësisht prejardhjes, etnike, ngjyrës së lëkurës, gjuhës i jep mundësi të jenë të barabartë.

“Ne përmes kësaj ekspozite deshëm të tregojmë se Kosova mund të duket edhe kështu, në fakt Kosova është kjo, por, nuk është e plotë. Në anën tjetër ne ende e kemi marginalizimin dhe sfidat e shumta me të cilat komuniteti romë ballafaqohet, si varfëria,” ka thënë Skenderi për magazinën TJETËR.

Ai më tutje ka thënë se hendeku shumë i madh i qasjes në arsim ose në punësim, ose në elemente të tjera të jetës publike krijon vështirësi, sepse për të tejkaluar këtë situatë ku shihen pjesëtarët e komuniteteve në rrugë, fëmijë nëpër semaforë duke kërkuar lëmoshë, familje të varfra. Ai ka shtuar se në këtë situatë duhet krijuar mundësi për një jetë dinjitoze këtyre komuniteteve.

“Duhet të mundësohet kjo nga institucionet shtetërore por edhe nga shoqëria. Kosova e cila për momentin përfaqësohet nga këta njerëz nëpër vendet e veta të punës, shumica e këtyre personazheve nuk merren me komunitetin, nuk punojnë vetëm për komunitete, janë kontribuues, janë pjesëtar aktivë në jetën shoqërore publike. Kemi mësues që punojnë në shkolla publike, policë që ofrojnë shërbime për të gjithë qytetarët e Kosovës, ministra në qeveri që punojnë për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe kjo është e ardhmja, ajo çfarë duam të shohim për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve dhe jo vetëm,” – është shprehur ai.

Skenderi ka shtuar se pavarësisht tentimeve shoqëria nuk ua ofron këtë mundësi, është mjaft e vështirë pasi si pjesëtar i komunitetit rom, ashkali ose egjiptian, duhet të tentosh dy-trefish ose pesëfish më shumë që të arrish aty ku ndoshta për një shqiptar ose edhe serb është një rrugë më e lehtë.

Kiki Rrahmani ka thënë se ekspozita “Testament” është ekspozitë e cila njëfarë mënyrë gërsheton të kaluarën me të tashmen si dhe me të ardhmen, pasi dy personazhe të ekspozitës janë tashmë të ndjerë, që i takojnë të kaluarës siç është Kujtim Paqaku dhe Negjip Menekshe, pastaj të moshës së mesme të cilët i përkasin realisht të tashmes, si dhe personazhe të cilët janë në të ’20 dhe që pritet në të ardhmen të jenë arkitekt të jetës së tyre.

“Ekspozita “Testament” na lë të kuptojmë se si këto personazhe të komuniteteve të marginalizuara në Kosovë, mundem të ia dalin dhe të ngritën pavarësisht sfidave dhe barrierave të cilat i hasin gjatë jetës së tyre. Kjo ekspozitë na sjell një reflektim sa i përket edhe identiteteve të tyre të veçanta, siç janë romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët e mbi të gjitha luftën e tyre në këtë jetë për të qëndruar “Vertikalisht”,’ ka shtuar më tutje Rrahmani.

Ajo ka shtuar se është shumë e rëndësishme që të bëhet kujdes, qoftë me apo pa vetëdije të mos përdoren fjalë pezhorative për këto komunitete, të cilat mund të ndikojnë pikërisht edhe në vetëbesimin e tyre, po edhe në identitetin e tyre.

“Është mirë që të punojmë së bashku me komunitetet e po ashtu me institucionet e vendit, që t’u hapim rrugë dhe dyer që ta tregojnë punën dhe talentin e tyre dhe përkushtimin, që ndoshta me vite ndoshta nuk është zbuluar pse nuk kanë mundur ta shfaqin për arsye të ndryshme, qoftë për shkak të rrethit, qoftë për shkak të kushteve jo të mira ekonomike, apo edhe për shkak të paragjytimeve dhe bullizimit që e hasin çdo ditë. Është mirë të reflektojmë mbi ndërgjegjësimin apo edukimin e vetë neve dhe gjeneratave që do të vijjnë, që t’i trajtojmë të gjithë dhe të kemi një shoqëri më të drejta sa më të barabarta” ka thënë Kiki Rrahmani për magazinën TJETËR.

Padyshim, një nga mesazhet më të fuqishme që buron nga kjo ekspozitë është ai i frymëzimit për gjeneratat e reja. Në sy të të pranishmëve, portretet u shndërruan në pasqyra të mundësive, dëshmi se pavarësisht rrënjëve të vështira, njeriu ka forcën për të ndërtuar një të ardhme ku vendin e paragjykitimit e zë dinjiteti, e ku pengesat lihen pas për të çelur rrugë të barabarta për të gjithë.

TJETËR është një faqe që funksionon në baza vullnetare. Mbështet punën tonë duke pëlqyer faqen tonë në Facebook (KËTU) dhe kanalën tonë në YouTube (KËTU).



“KUFIRI – TRAGJEDIA PËRTEJ VIJËS SË HESHTJES”

7 Prill, 2025 - 20:27

tjeter.net/kufiri-tragjedia-pertej-vijes-se-heshtjes/

Shfaqja teatrale “ Kufiri ” e cila është reprizuar në teatrin “ Oda ” është një vepër që, përmes një gjuhe simbolike dhe një strukture dramatike është ndërtuar me ndjeshmëri dhe ironi therëse, duke zhveshur realitetin e dhimbshëm të migrimit – një fenomen që nuk përfaqëson më vetëm një nevojë ekonomike, por një dëshpërim ekzistencial, një kërkim të shpresës përtej kufirit, përtej kufomës së një bote që ka humbur empatinë.

Që në fillim, publiku përballet me një pamje tronditëse, një fëmijë 12-vjeçar i cili ka ndërruar jetë pranë kufirit, një imazh që në mënyrë të heshtur por tronditëse flet më shumë sesa gjithçka tjetër. Kjo skenë e parë nuk është thjesht një hyrje dramatike – ajo është një akt akuzues ndaj një bote që ka dështuar të mbrojë më të pambrojturit.

Por “Kufiri” nuk ndalet tek tragjedia – ai shkon më tej, duke ironizuar mediat bashkëkohore, të cilat, në vend që të ngrenë vetëdijen apo të nxjerrin në pah dramën humane, e shndërrojnë edhe një kufomë të njomë në një mjet për klikime. Gazetarët në skenë nuk janë mbartës të së vërtetës, por zbrazësi cinike që filmojnë pa mëshirë, pa empati, pa reflektim. Këto personazhe janë një pasqyrë e mediave që kanë harruar misionin e tyre etik dhe e kanë kthyer tragjedinë në spektakël. Shfaqja kështu demaskon një industri informacioni të dehumanizuar që e konsumon dhimbjen si mall tregu.

“Kufiri” mund të lexohet si një manifest modern mbi kufijtë – jo vetëm ata gjeografikë, por edhe kufijtë etikë, kufijtë e përgjegjësisë, kufijtë e ndjeshmërisë. Kufiri nuk është më një vijë që ndan vendet, por një mur që ndan njeriun nga njeriu, që ndan jetën nga indiferenca. Shfaqja ndërton një rrëfim ku estetika bashkohet me kritikizmin shoqëror, dhe ku teatri nuk është vend eskapizmi, por një mjet për t’i thirrur ndërgjegjes.

“Kufiri” është shkruar nga Ana Ristoska Trpenoska , me regji të Sovran Nrecajt dhe luajtur nga aktorët: Shpëtim Slemani , Verona Koxha , Blend Sadku , Kosovare Krasniqi dhe Leart Nrecaj .

“Për mua ka qenë me rëndësi të eksploroj më shumë mbi këtë temë, për arsye se shumica e njerëzve të cilët jetojnë në Kosovë, në përgjithësi në Ballkan, një prej qëllimeve të tyre jetësore, me aq sa më ka rastisë të flas me njerëz nga këto vende të ndryshme e kam parë që ai qëllim i tyre është ta lëshojnë vendin, të zhvendosen, edhe shumë të tjerë të cilët ndoshta e kanë arritur këtë qëllim, prapë është njëfarë pengu që i mbanë në vendin e tyre. Janë të huaj edhe atje edhe në vendin e tyre,” – ka thënë Sovran Nrecaj njëherazi edhe regjisor i shfaqjes.

Ai më tutje ka theksuar se ka qenë e rëndësishme të tentohet që këto storje të ndryshme, të këtyre njerëzve të ndryshëm, në rrethana të ndryshme, të nxirren prej statistikave për t’u dhënë zë storjeve të tyre në skenë.

“Pak a shumë ironizohet ose tentohet të paraqitet një version i mediave, shumë versione të policëve kufitarë dhe të politikave të ndryshme të cilat për mendimin tim kanë ndikuar që të shumëfishohet kjo dhimbje dhe kjo lloj fatkeqësie e migrimit ilegal. Për t’u kthyer tek mediat, kemi tentuar që përmes mediumit tjetër që është video të paraqiten dy lloje të mediave, ose ndoshta dy lloj gjërash që i shohim në ekran, njëra është ku paraqitet një gazetarë e cila tenton të ngrehë më shumë prej kësaj teme, me qëllimin kryesor që është për click-bite dhe pjesa tjetër është ku shihen video reale të njerëzve të ndryshëm të cilët kanë migruar”, ka thënë ai.

Simbolika e disa drunjve që bien nga duart e një prej personazheve dhe përsëri rregullohen dhe kthehen në gjendje të mëparshme.

Nrecaj ka theksuar për magazinën TJETËR se fillimisht, ajo pjesë është një shkëputje e fëmijërisë së atij djali i cili lojën e tij detyrohet ta bëjë në një rrethanë krejt të ndryshme, që nënkupton distancën, përmes afërsisë dhe distancës së prindërve të tij, njëri në mërgim e tjetri duke e kërkuar djalin në ato skena, ai në njëfarë forme detyrohet që lojën e tij imagjinare ta bëjë në këtë kufirin imagjinar, ato copëza druri apo ajo pjesë e lojës mundet ndoshta të mendohet si një perceptim i një shoqërie përmes fëmijëve, ku ai i bën edhe shikuesit pjesë të saj, e cila rrëzohet, shkatërrohet dhe prapë rregullohet ose formohet, ajo ka qenë ideja e saj si simbolikë e këtyre copëzave të drurit.

Shpëtim Selmani ka thënë se migrimi nuk është veç sot, migrimi, lëvizjet e njerëzve janë prej shumë vitesh, mendoj që sot migrimi shkaktohet prej krizave politike, edhe Ballkani i Hapur si pjesë e shfaqjes, janë elemente politike që i ka futur autorja të tregojë që gjithmonë për shkaqe politike, si luftërat e kështu me radhë, njerëzit edhe migrojnë.

“Në botëkuptimin tim personal, për mua është një problematike, ndoshta edhe të them është pak qesharake, pak utopike, por, mendoj që përderisa ne kemi kufij, ne nuk e kemi arritur ende një nivel si njerëz, si periudhë në një nivel të vetëdijesimit për njëri-tjetrin, sepse mendoj që bota na takon krejtve, komplet edhe këto shtete, vijat kufitare që përmenden tërë kohën në shfaqje shpesh dinë me qenë katastrofike”, është shprehur Selmani.


Selmani ka shtuar se edhe sot kujtohet Bllaca me shumë dhimbje, pas shumë vitesh, kështu që autorja dhe regjisori, Sovrani në këtë rast, e kanë gjetur një temë e cila vërtetë është aktuale dhe nuk do të thotë që nuk ka qenë më herët, dhe nuk do të thotë që nuk do të jetë prapë aktuale, është diçka që përjetohet nonstop.

“Mendoj se është temë universale dhe është shfaqje që shikohet kudo, jo vetëm në teatrin Oda. Me të mund të shkosh kudo, edhe në Afrikë, është një temë e cila i prek të gjithë, na prek të gjithëve edhe gjithë kjo mendoj për shkak të vetëdijesimit të ulët të njerëzve kudo nëpër botë”, ka thënë aktori i kësaj shfaqjeje Shpëtim Selmani për magazinën TJETËR .

“Shumë referenca në art, shfaqje, letërsi dhe kudo kanë kuptime të ndryshme dhe është interesant se si i interpretojnë njerëzit, nuk mendoj që interpretohen vetëm në një mënyrë, p.sh. unë si aktor e interpretoj ndryshe, ndoshta e interpretoj si një ëndërr të një fëmije që thyhet tërë kohën për shkak të përkatësisë së tij etnike, sepse ne lindim pa e zgjedhur identitetin, ne lindim pa i zgjedhur faktorët kryesorë që e determinojnë jetën tonë e që ne nuk i zgjedhim edhe na hidhen si konstrukte hyjnore në duar” ka shtuar ai.

“Kështu që në perceptimin tim personal mund të jetë edhe diçka tjetër, është një ëndërr që i prishet një djali, është një ëndërr që të gjithë e kanë, është një ëndërr e përbashkët mbase për një botë më të mire ose diçka më të mire, për një shtëpi le të themi, mbase ato copëza druri simbolizojnë një shtëpi ku të gjithë neve na takon të ndërtojmë atë shtëpi dhe të jetojmë së bashkë dhe të lumtur brenda asaj shtëpie”, është shprehur Selmani.

Në fund të fundit, “Kufiri” është një thirrje – një apel që na kujton se çdo fëmijë që humb jetën në kufi është një dështim i përbashkët, dhe se as media, as politika, as qytetaria nuk mund të qëndrojnë neutrale para këtij realiteti. Shfaqja na kujton se kufijtë nuk janë vetëm aty jashtë, në tokë të huaj – por edhe brenda nesh, sa herë që nuk reagojmë, nuk ndiejmë, dhe nuk veprojmë.



**“DEADLINE”:
GAZETA SI ART
SKENIK NË EPOKËN
PA FJALË TË
SHTYPUR**

4 Maj, 2025 - 16:55

tjeter.net/deadline-gazeta-si-art-skenik-ne-epoken-pa-fjale-te-shtypur/

Në një kohë kur në Kosovë nuk botohet asnjë gazetë ditore, kur fjala e shtypur është përjashtuar nga rituali i përditshëm i qytetarit, shfaqja baletike “Deadline” vjen si një homazh i ndjerë – por edhe si një kritikë e heshtur – ndaj një realiteti ku gazetaria e shkruar është zhdukur nga qarkullimi. Në Ditën Botërore të Vallëzimit koreografi Sead Vuniqi, përmes një koreografie që i ngjan një redaksie të gjallë, rikthen në skenë epokën e artë të shtypit, duke e vendosur atë përballë një shoqërie që sot e ka zëvendësuar gazetën me zhurmën e ekranit dhe me përmbajtje të shpejta, të konsumueshme e të harrueshme.

Shfaqja nis në errësirë, me pesë makina shkrimi dhe po aq balerinë që më vonë rriten në numër bashkë me ndriçimin gradual të skenës. Redaksia merr formë hap pas hapi, gazetat e shtypura bëhen pjesë e koreografisë, fotoreporterët nisin lëvizjen, balerinët ndahet mes atyre që shtypin në makinë dhe atyre që kërcëjnë, derisa të gjithë bashkohen në një ritëm të përbashkët – një ditë pune intensive në një redaksi që ekziston më shumë në kujtesë sesa në realitet.

Në qendër të skenës, një figurë spikat: kryeredaktori, që kundërshton, proteston, debaton – jo vetëm për shpejtësinë e punës, por ndoshta edhe për drejtësinë e fjalës së shkruar, për vërtetësinë e lajmit dhe për idealin e gazetarisë që nuk e komprometon titullin. Ky akt ndan koreografinë nga thjesht estetika – dhe e ngre në një nivel më të lartë simbolik, “Deadline” nuk është vetëm një rikthim në kohë, por një ballafaqim me të tashmen.

“Deadline” është më shumë se një balet, është një dokument artistik i një epoke tashmë të perënduar në Kosovë, ku mungesa e gazetave të shtypura është bërë shenjë e një boshllëku kulturor. Nëpërmjet një hulumtimi të kujdesshëm, në skenë bëhen pjesë edhe disa gazeta të cilat ishin shtypur në të kaluarën dhe kishin histori, ndër to edhe “Rilindja”, të cilat në vete mbajnë ngarkesa simbolike të shumanshme. E në këtë shfaqje gazetat bëhen vetëm subjekt i vallëzimit, si një kujtesë kolektive dhe reflektim mbi kohën.

Shfaqja ndërton një realitet paralel me të sotmen dhe kjo bën që kritika e saj të jetë e fuqishme pa qenë eksplicite. Ajo nuk predikon, nuk moralizon, por përmes trupit dhe lëvizjes flet për një kohë kur gazetaria kishte ritëm, hierarki profesionale, kolegjalitet e pasion. Ajo flet për gazetatat që frymonin çdo mëngjes dhe që i jepnin qytetarit jo vetëm informacion, por edhe mendim, vizion, analizë.

Koreografi i shfaqjes së baletit “Deadline”, Sead Vuniqi ka thënë se për realizmin e këtij baleti është frymëzuar nga rëndësia që dikur kishin gazeta për informimin publik. Ai më tutje ka shtuar se, gazetatat dikur ishin burimi i vetëm i informimit, kurse gazetaret bënin një punë mjaft dinamike për të arritur te lajmi dhe informuar sa më parë publikun.

Vuniqi ka thënë se ishte lexuesi i rregullt i gazetave ditore, përmes së cilave informohej për ngjarje të ndryshme nga kultura, sporti e fshat e tjera.

“Duke pasur parasysh zhvillimet teknologjike, ku kemi mundësi të informohemi nga telefoni për zhvillimet që ndodhin kudo në botë në kohë reale, prapë se prapë gazeta mungon në shoqërinë tonë dhe pse të mos kemi edhe ne sikurse shumë vende të tjera”, ka thënë Vuniqi për magazinën TJETËR.

Ai ka shtuar se makinat e shtypit i prezantojnë edhe personazhet. Në fillim janë 4-5 personazhe kryesore të shfaqjes, e gjithë ngjarja zhvillohet mes këtyre personazheve.

“Shfaqja flet edhe për kohën, kur vjen koha të “Deadline”, do të thotë është një kohë e caktuar, ku ti duhet patjetër të përfundosh artikullin i cili duhet të dalë në shtyp të nesërmen dhe gjithë kjo ngrit tensione sepse nuk ka kohë të mjaftueshme, nuk ka makina shtypi të mjaftueshme, mungon edhe hapësira e nevojshme për të kryer punën, e shumë gjëra të tjera të cilat i mungojnë një redaksie” ka thënë ai.


Aulonë Nuhiu ka thënë se shfaqja “Deadline” është e ngarkuar dhe që vjen me një temë, e cila ia vlen që është trajtuar edhe përmes baletit. Ajo ka shtuar se kjo na ka kthyer në kohë dhe na ka kthyer në një periudhë kur janë përdorur makinat, janë lexuar gazetatat e të gjitha këto i kemi përjetuar edhe duke e përgatitur shfaqjen.

“Nuk mund të them ndoshta që është shumë kritikë, por në një rëndësi anë jemi munduar ta shprehim vlerën e gazetarisë, të gazetave dhe vlerën e kohës si ka qenë atëherë, sepse tash teknologjia na ka rrëmbyer pak si shumë dhe shfaqja si e tillë na kthen shumë në kohë”, ka shtuar Nuhiu për magazinën TJETËR.

Ajo ka theksuar se si në çdo vend të punë edhe në redaksi janë disa persona që kanë një rol kanë një punë më të rëndësishme.

“Në këtë rast ishim në pesë personazhet kryesore, unë isha si fotoreportere dhe secili prej nesh në fillim paraqitet duke e shfaqur karakterin e vet, pastaj inkuadrohen edhe balerinët e tjerë dhe në shumë pjesë të shfaqjes shihet edhe presioni edhe dëshira e secilit për të punuar dhe për të nxjerr lajme sa më të rëndësishme, ku përmes kësaj shihet puna dhe dëshira e çdo gazetari për ta nxjerrë një lajm të mirë, një lajm të rëndësishëm” ka thënë balerina Aulonë Nuhiu.

Në një shoqëri që sot nuk siguron asnjë gazetë të shtypur, ku gazetaria shpesh është nën presion, e paushqyer nga struktura, publiku dhe shteti, “Deadline” vjen si një alarm i artikuluar përmes artit. Është një përkujtues, por edhe një thirrje për kthim te thelbi – te fjala me peshë, te redaksia si hapësirë mendimi, dhe te gazetaria si profesion, jo si rrjedhë.



other things end up being more important.

**MOS KËQYRNI
SERI, KËQYRENI
KËTË SERI:
UNBELIEVABLE**

28 Korrik, 2025 - 12:05

tjeter.net/mos-keqyrni-seri-keqyreni-kete-seri-unbelievable1/

Kalo menjëherë te PJESA KRYESORE nëse s'ke vakt.

Ditët e fundit e pashë një seri që quhet “Unbelievable” (shq. E pabesueshme). Është kriju prej Sussannah Grant, Ayelet Waldman dhe Michael Chabon në vitin 2019 dhe bazohet në storien e një artikulli të vitit 2016 që e fitoi Çmimin Pulitzer.

Për mos me zgjatë, kjo është pak a shumë fabula:

Një çikë e mitur – me emrin Marie, që sa kish fillu me jetu e vetme – përdhunohet prej një një personi që i futet me forcë në banesë. Ajo e denoncon rastin në Polici, dhe e jep deklaratën e vet nja katër-pesë herë. Mirëpo, në deklaratë i dalin disa kontradikta të vogla dhe policët hetues nisin me dyshu mos po rren. Më pas, dyshimi rritet kur reagimin e saj ndaj dhunimit nënat kujdestare (është edhe fëmijë jetim, meqë ra fjala) me shokë e shoqe të saj e konsiderojnë atipik. Pastaj, shikimi del te karakteri i saj. Thonë se e kërkon kahpak vëmendjen. Se është rritë në ambiente të dhunshme. E kështu me radhë.

Policët nuk i besojnë më. Ia paraqesin kontradiktat. Ajo reziston për pak, mirëpo tërhiqet. Është përvojë traumatike dhe s'ka nerva me e duru gjatë pa e kuptu që ai pranim ia kthen jetën përmbys. Iu thotë, okay kam gënjy, s'më ka dhunu askush.

Paralelisht, nja dy hetuese shumë të zonja i kishin ra në gjurmë një dhunuesi serik. S'do shumë mend me kuptu që ai doli se ishte edhe dhunuesi i Maries. S'është as 'spoiler' ky, mos t'jau ninë.

Është seri që e paraqet të dhimbshmen në shumë drejtime, qysh zakonisht edhe është. E dhimbshme kur i sheh ata policë të këqij e neglizhentë. E dhimbshme kur e sheh jetën kah i përkeqësohet Maries si pasojë e asaj 'rrene'. Dhe më e dhimbshmja, kur e sheh se qysh veprojnë njerëzit që “jau ninë” për Marien.

Se çka ndodhi më tej s'po kallëzoj. Mirëpo, po e ndaj një pjesë të shkurtër që më la më së shumti përshtypje.

Pjesa kryesore

Kjo ndodhi në kohën kur po merrej vesh ngadalëdalë se Marie s'kishte rrejtë për dhunimin. Se në fakt kishte rrejtë se kishte rrejtë. Ishte te terapistja.

Ajo e pyet se a kishte diçka që kish mësu prej kësaj historie të tmerrshme, që në raste tjera kur përballet me padrejtësi me vepru ndryshe?! Me fjalë tjera po i thoshte se mos ndoshta nuk duhej me rrejtë që kish rrejtë?!

Fjalët e saj ishin tamam fjalë me një farë vërtetësie përtej tingujve e shkronjave. Me një farë vërtetësie të përtejme. Marie thotë që nëse i kish ndodhë prapë, jo që s'kish rrejtë po kish rrejtë “ma shpejt e ma mirë”. Pra, s'e kish lajmëru rastin hiç në Polici.

“S'ka lidhje sa shumë thotë dikush që ia ninë për ty. S'jau ninë. Jo aq sa duhet. Ndoshta kanë dëshirë me jau ni për ty, ose provojnë që me jau ni, ama- gjithë janë do sende që n'fund dalin më t'rëndësishme për ta se ti.

Kisha rrejtë.

Se edhe për njerëzit e mirë- edhe për ata që iu beson, kur e vërteta s'iu konvenon – kur s'iu përshtatet me botën e tyre – s'të besojnë.

Edhe nëse seriozisht jau ninë për ty- s'jau ninë për ty”

Shënim: E përktheva “they don't care” si “s'jau ninë” e jo “s'iu bën” sepse po ka më shumë kuptim. Nëse je prej Shqipërisë e s'po e kupton, atëherë shko në lesh se s'je njeri i mirë. Qysh ka mundësi mos me kuptu një shprehje kaanaaq popullore mes kosovarëve?! Fucking hell.

Çdo të mirë në jetë dhe jashtë saj!

SELAKELË
SERVILË
KUNDËR

KATUNARËVE

QYTETAR-KATUNAR: HISTORIA E GËRDITSHME E NDASISË MES KOSOVARËVE

8 Gusht, 2025 - 15:55

tjeter.net/qytetar-katunar-historia-e-gerditshme-e-ndasise-mes-kosovareve/

Ndasia “qytetar-katunar” vazhdon me u shfaqë në Kosovë pak a shumë çdo tre-katër muaj. Megjithëse zakonisht bëhet përmes cinizmit e ironisë, kjo ndasi është shumë serioze dhe e përfsheh një histori të gjatë por shumë të shëmtuar të abuzimit me pushtet.

Hajde e shohim me kujdes.

SHIKO SI VIDEO:

Ndasia qytetar-katunar fillon të shprehet në Kosovë kur merr hov industrializimi. Pra, prej vitit 1950 e tutje.

Kosova prej një vendi krejtësisht agraro-rural nisi të bëhej gradualisht vend industrial. U hap administrata, u hapën fabrika e ndërmarrje shtetërore që krijuan një numër të konsiderueshëm vendesh të reja pune. Një numër i madh shqiptarësh zbathën opingat, paluan shatin e kacinë dhe i thanë lamtumirë përfundimisht lopës.

Sidoqoftë, industrializimi i Kosovës s’ ishte transformim i shpejtë e vijëdrejtë. Punëtori kosovar i Ramiz Sadikut në qytet vazhdonte t’i ruante lidhjet e tij me kulturën fshatare. E bile, edhe midis qytetit – për shembull midis Prishtinës – vazhdonte të lulëzonte bujqësia e blegtoria. Vetë prishtinalitë e vazhduan ruajtjen e kulturës fshatare me fanatizëm përkundër presionit të madh nga pushteti. Dhe plot prej tyre ia dolën mbanë.

Ndasia qytetar-katunar qysh në ato fazat fillestare të saj e kishte në thelb profesionin e jo vendbanimin. Kjo sepse qytetarët – për të cilët do të flasim më pas – ishin gati të gjithë nga fshati. Ndërsa ata pasanikë që ishin nga qyteti e s’merreshin me bujqësi u shpronësuan e poshtëruan në emër të luftës kundër borgjezisë.

Reforma agrare e vitit 1945 për kolektivizimin e bujqësisë në Jugosllavi dështoi keq. Duke parë se sa të vendosur ishin shqiptarët në rezistencë kundër kësaj reforme në një anë dhe në tjetrën pasojat shkatërrimtare në prodhim në Bashkimin Sovietik, Josip Broz Tito më 1948 jozyrtarisht vendosi me ndjekë rrugë tjetër. Mirëpo, kjo rrugë që iu la fshatarëve arat e tyre s’u bë me zemër e prandaj tensioni mes pushtetit e fshatarësisë veç sa u rrit.

Në të njëjtën kohë, po ndodhte edhe një tjetër transformim shoqëror. Pati një ardhje të madhe njerëzish nga fshatrat përreth Prishtinës në Prishtinë. Por, ndasia qytetar-katunar s’arriti dot që ta fuste në qendër tamam vendbanimin. Ta zëmë, ata që erdhën nga fshatrat në Prishtinë erdhën sepse braktisën punët e fshatit shkaku i presionit shtetëror. Dhe meqë një pjesë e madhe e prishtinalive patriotë vazhduan të merreshin me punë fshati midis Prishtinës, kjo e nxiti paragjykimin se këta prishtinali ishin prapanikë e katunarë. Jo katunarët e sapoardhur në kryeqytet. Kështu ndodhi edhe nëpër krejt qytetet tjera të Kosovës.

Mendojeni edhe njëherë pra sa paradoksale tingëllon kjo për kohën tonë. Në Prishtinë s’merreshin me bujqësi ata që erdhën prej fshatrave. Ata kishin ardhë për punët e reja jofshatare që ishin hapë – një pjesë e madhe madje edhe për t’u bërë pjesë e pushtetit. Në Prishtinë – për qytet po flasim – merreshin me bujqësi veç prishtinalitë e vjetër.

Është pak të thuhet se komunizmi jugosllav marrëdhëniet me fshatarësinë i kishte mjaft komplekse. Por, këto marrëdhënie s’kishin veç paragjykime banale në brendi. Ta zëmë, vetë Josip Brozi ishte një fshatar me vetëm katër vjet shkollë. E prejardhje nga fshatarësia kishte edhe pjesa dërmuese e udhëheqësisë jugosllave. Mbi 70% e saj sipas studiuesit Allen H. Barton. Kjo për shkak se klasa borgjeze – siç e thamë – ishte rrëzu. Mirëpo, fshatarësia u bë problematike për fshatarët e qytetarizuar udhëheqës në Jugosllavi kur u krijua ajo që disidenti më i njohur jugosllav Millovan Gjillasi e quan “KLASA E RE”.

Siç e dimë, komunizmi pretendonte ndërtimin e një shoqërie pa klasa. Ku të gjithë njerëzit do të ishin të barabartë. Ku s’kishte marrëdhënie pronësie.

Por, ajo që ndodhi – siç na tregon vetë Gjillasi që ishte Zëvendës President në Qeverinë e Titos – ishte krijimi i një klase të re që përbëhej nga burokratë të cilët morën pronësinë e krejt asaj që në letra thuhej se iu takonte të gjithëve.

“Dalja në pah e klasës së re është fshehur nën frazeologjinë socialiste, dhe më e rëndësishmja, nën format e reja kolektive të pronësisë. E ashtuquajtura pronësi socialiste është maskim i pronësisë së vërtetë nga burokracia politike.” – shkruante Gjillasi.

Lakmia e kësaj klase të re ishte e pangopshme. Dhe pasi fshatarësia nuk i dorëzoi pronat që kishte kjo krijoi një tension të madh në klasën e re. Fshatarësia përçmohej e fyhej madje edhe në mbledhje të partisë komuniste.

Qe çka shkruan Millovan Gjillasi që e njihte këtë problem nga brenda:

“Klasa e re u ndje e pasigurt për aq sa kishte edhe pronarë tjerë përveç atyre. S’donte të ndjente rrezikun e sabotazhit në furnizimin ushqimor apo në lëndën e parë agrikuturore. Kjo ishte arsyeja direkte për sulmin ndaj fshatarësisë. Sidoqoftë, kishte edhe një arsye të dytë, një arsye klasore: fshatarësia mund të përbënte rrezik ndaj klasës së re në situata jostabile-. Si rrjedhojë, burokracia u shumua edhe nëpër fshatra po ashtu.”

Klasa e re ishte aq e korruptuar e aq parazite sa për ta mbuluar veten provoi që këto karakteristika t’i fuste te krejt shoqëria qytetare përmes klientelizmit. Mos harroni, po flasim për një ekonomi të mbyllur e të kontrolluar që e bëri pushtetin e atyre njerëzve në majë të asaj klase pushtet përnjëmend monstruoz.

“Besohej që dallimet mes qyteteve dhe fshatrave, punës intelektuale dhe fizike, dalëngadalë do të zhdukeshin; por ato veç sa u rritën,”

U rritën pra. Dhe do të rriteshin deri në përmasat që ndasia qytetar-katunar të na futej edhe në ditët e sotme. Dhe na u fut në ditët e sotme sepse- klasa e re rrënjosi edhe frikë e përçmim besëtyt për fshatarët. Duke folur për harxhimet marramendëse e të paarsyeshme që i bënte Jugosllavia, qe çka shkruan Millovan Gjillasi:

“Sa shumë i kushton një shteti agrikultura stagnuese shkaku i frikës supersticioze të komunistëve ndaj fshatarit dhe shkaku i investimeve të paarsyeshme në industri të rëndë?”

Nisur nga ky averzion i pabesueshëm shkaku i marrëdhënieve të pronësisë, përmbledhtazi mund të themi edhe se çështja e ndasisë qytetar-katunar u bë çështje e pozitës së filanit në strukturën e prodhimit. Fetishizimi i profesioneve – për të cilin besojmë se keni dëgju – ishte maskim i fetishizimit të përzgjedhjes që bëhej nën kushte klienteliste nga anëtarët shqiptarë të klasës së re jugosllave. Ky është djali i profesorit. Ajo është çika e gazetarit. Ky është qeni i ambasadorit. Ai është kerri i inxhinierit. Unë jam djali i mjekut. Kjo është mbesa e agronomit. E kështu me radhë. Çka shprehin këto? Thjesht afërsinë që këta njerëz e kishin me të ashtuquajturën klasë e re.

Pak a shumë, të gjithë këta njerëz të përzgjedhur me familjet e tyre – pavarësisht se ku kishin lindur – u bënë qytetarë sepse i shërbenin në një mënyrë a tjetrën grupit të parazitëve në pushtet. Të gjithë ata njerëz që mbetën jashtë përzgjedhjes – pra në jetë fshati – u quajtën fshatarë, prapanikë, selakë. Por, paragjykimet ishin edhe më të thella se kaq. Katunari shihej edhe si i pamoralshëm shkaku i një etike të çoroditur që e shihte me automatizëm anëtarin e partisë komuniste si primordialisht të moralshm meqë s’kishte devijuar politikisht.

Më së rëndi nga kjo ndasi e pësoi rajoni i Drenicës. Besoj, e keni vërejt që edhe sot drenicakët shihen si katunarët më të mëdhenj nga ata njerëz që operojnë me kësi paragjytime. Kjo për shkak se pikërisht në Drenicë rezistenca ndaj reformës agrare (1945-48) kishte qenë më e madhja. Ashtu siç kishte qenë edhe rezistenca ndaj aksionit makabër të konfiskimit të armëve (1954-56).

Natyrisht, kjo klasë e re kishte edhe interes të krijonte ndasi të thella mes njerëzve. Por, siç e shpjegon Gjillasi ajo formoi një ndërgjegjje të fortë klasore, e që nënkupton se paragjykimi i katunarit i vinte edhe natyrshëm. Mos të harrojmë që po flasim për një pushtet që ia kishte përcaktuar vetes edhe detyrën e formimit të marrëdhënieve shoqërore – e që e çoi drejt preokupimit pervers me jetën private të njerëzve. Kjo klasë perverse s'e përcaktonte veç kush ishte qytetar e kush katunar. E përcaktonte edhe se ku do të jetonin njerëzit, në cilat banesa e shtëpi. Kë do ta kishin komshi. Me kë duhej të rrinin e me kë jo. E me raste, edhe me kë do të martoheshin e me kë jo. Me kalimin e viteve, regjimi e bëri të pamundur që një zyrtar shteti dhe një tregtar të ishin komshi të njëri-tjetrit. Meqë ra fjala, besoj e keni vërejt se çfarë përçmimi ende ekziston për tregtarët – që shpesh quhen pazарxhi e tyxharë?! Eh, edhe ai përçmim vjen prej asaj klase të sëmurë pas idesë se i takonte të kishte nën pronësi gjithçka.

“Ai që kap pushtet kap privilegjet dhe indirekt kap pronat shoqërore. Për rrjedhojë, në komunizëm, pushteti apo politika si profesion është ideali i atyre që kanë dëshirën apo shpresën e të jetuarit si parazitë nën kurrizin e të tjerëve.” (58)

Këta parazitë shqiptarë që jetuan në kurrizin e të gjithë shqiptarëve tjerë në Kosovën e asaj kohe me kalimin e viteve i përbrendësuan edhe paragjykimet e më të fortëve për veten. Pra, edhe paragjykimet etnike. Edhe pse ishin qytetarizuar e i kishin lënë opingat menjatë – atyre iu dukej ende vetja katunarë sepse si të tillë shiheshin nga serbët. Dhe prandaj, për ta bërë një hop tjetër të madh kulturor shumë prej tyre e realizuan edhe ëndrrën më kulmore: të martoheshin me gra serbe. Këto martesat e tyre ndëretnike po ndodhnin derisa midis Prishtinës – në korzon e saj – serbët s'pranonin as të shëtiteshin në një rrugë me shqiptarët. Ata ecnin në një anë, shqiptarët në tjetrën. Për qytete tjera as që po flasim.

Por, ky realitet që e shprehte midis qyteti këtë ndasi s'i interesonte burokratëve shqiptarë që kishin krijuar marrëdhënie klienteliste me shqiptarët tjerë. Ishin ndjenjesisht të shkëputur. Ata shpërndanin thashetheme e përçmime e besëtytni dhe shijonin privilegjet që u jepeshin.

“Një mendje e shtypur njerëzore detyrohet t'i nënshtrohet korrupsionit. Sistemi komunist i persekuton, i dyshon dhe i shtyn drejt vetëkritikës njerëzit e saj kreativë. Servilëve iu ofron “kushte pune “ shumë atraktive, honorare luksoze, shërblime, villa, qendra pushimi, zbritje, vetura, mandate si ambasadorë-”

Ky fragment nga Gjillasi ndodhet në librin “ Klasa e re” për të cilin ai do të burgosej menjëherë pas botimit për t'u bërë më pas një prej disidentëve më të njohur jugosllavë në botë.

Pra, po e shihni që s'është veç punë qyteti a katuni këtu. Është goxha më e thellë dhe goxha më e ligë. Kemi një klasë shqiptarësh që kontrollonte gjithçka, e cila në një anë kishte tension të pronësisë me fshatarësinë e nga tjetra edhe e përbrendësoi shikimin racist serb për ta. Prandaj, kur e përdorim në pezhorativ termin katunar në përbartim në këtë kohë ngarkesat e forta ideologjike të një klase parazitësh të korruptuar.

Siç e dimë, skema e prodhimit u përmbys në vitet '90 kur nacionalizmi serb u bë haptazi armik i shqiptarëve. Dëbimet masive dhe largimet vullnetare të shqiptarëve nga puna na bënë të gjithëve katunarë. Të vetmit qytetarë në atë skemë të pështirë mbetën serbët. Por kjo vetëm sa e rriti solidaritetin mes nesh. Një solidaritet që u prish sapo erdhi një formë e re e marrëdhënieve të bazuara haptas në pronësinë: kapitalizmi.

Sot, ndasia qytetar-katunar ndryn në brendi thuajse të njëjtat besëtytni e paragjykime që i nxitën parazitët e asaj kohe në pushtet. Ajo që mendohet për katunarin sot është po ajo që mendohej për të në vitet '50 e '60. Ai është një prapanik i neveritshëm me disa mangësi primordiale që e dallojnë nga qytetari. Natyrisht, prapaniku i neveritshëm në këtë mes është vetë ai që e shpreh apo nënkupton këtë dallim. Selaku në këtë mes është vetë ai që e ushqen supremacinë.

Natyrisht, ekzistojnë dallime të shumta kulturore, edukative e vlerore mes nesh. Por, këto dallime janë individuale – ose më së shumti familjare – e jo grupe. Paramendojeni një prishtinali me edukim të lartë dhe formim të gjerë kulturor dhe një prishtinali analfabet që shahet nëpër komente të Facebook-ut, që pështyn në rrugë e që gërryen hundën para syve të tjetrit. Çka kanë të përbashkët? Ose dy drenicakë. Dy gjakovarë. Dy katunarë.

Për fat të keq, pas luftës më 1999 askush nga funksionarët e lartë shqiptarë në Jugosllavi nuk u gjykua për abuzimin me pushtet dhe korrupsionin endemik. Kishte një lloj amnistie të heshtur përkundër gjithë atij zarari horrorial që e bënë në gati pesë dekada. Për më keq, pati amnistim të heshtur edhe për torturat e persekutimet çnjerëzore të kryera gjatë asaj periudhe të gjatë. Por, është koha që ato të zbardhen e të shqyrtohen. Është koha që e vërteta të dalë në dritë! Parazitët përbindështa të asaj kohe duhet ta marrin dënimin e merituar, edhe nëse plot prej tyre tashmë kanë vdekë!

Kjo video/tekst nuk pretendon të ofrojë shpjegimin e plotë për këtë debeat. Synon që të nxis diskutim serioz në lidhje me këtë ndasi, por edhe në lidhje me mospërballjen me drejtësinë dhe mungesën e çfarëdo hetimi institucional ndaj zyrtarëve të lartë shqiptarë në regjimin komunist.



DO TË MBETENI GOJËHAPUR

**ULPIANA ËSHTË
SHUMË MË
INTERESANTE SE
QË KENI MENDU**

19 Gusht, 2025 - 17:34

tjeter.net/ulpiana-eshte-shume-me-interesante-se-qe-keni-mendu/

Zakonisht, kur përmendet Ulpiana përmendet Perandori Justinian. Dihej se ai kishte lindur në Dardani dhe prandaj supozohet se e kishte një farë lidhje emocionale me Ulpianën dhe trojet tjera dardane. Sidomos, meqë e kishte rindërtu krejtësisht pas shkatërrimit të saj. Por, e vërteta është më ndryshe.

Videoja:

Perandori Justinian ishte një perandor bizantin shumë autoritar që shtypte jo vetëm dardanët por edhe të gjithë popujt tjerë që i kishte nën sundim.

Sidoqoftë, lidhja më e fortë e Justinianit me Ulpianën merret rindërtimi që ai ia bëri qytetit. Për ata që s'e dinë: Ulpiana ishte shkatërru gati plotësisht prej një tërmeti të madh që kishte ndodhë në vitin 518, siç rrëfen edhe kronisti i asaj kohe Marcellinus Comes .

Nëntë vite më vonë, me t'u bërë Perandor, Justiniani e nisi një program masiv të rindërtimit nëpër Ballkan. Pra, jo vetëm në trojet dardane. Dhe s'ishte veprim nga dashamirësia e tij por nga nevoja që Perandoria të mbrohej nga sulmet e vazhdueshme të dakëve, e më vonë edhe Avarëve e Sllavëve.

Historiani i asaj kohe, Procopiusi, kishte tregu për rindërtimin e Ulpianës dhe emërtimin e saj nga Justiniani si Iustiniana Secunda. Ose, Justiniana e Dytë.

Ndërkohë, Justiniana Prima, pra Justiniana e Parë ndodhet në Serbi. Ky qytet ishte ndërtu po ashtu nga Justiniani prej fillimit më 535. Qysh në këtë emërtim, e vërejmë që Justinianit s'i bënte fort për Dardaninë e për Ulpianën e më-the-e-të-thashë.

Mbishkrimet e gjetura në dy vitet e fundit – e që u bënë edhe lajm ndërkombëtar – e lidhin direkt Perandorin Justinian dhe gruan e tij, Teodorën, me qytetin e Ulpianës. Janë bërë nga vetë Perandori Justinian. Sidoqoftë, po flasim thjesht dhe vetëm për disa vite ekzistencë të një qyteti të lashtë e jashtëzakonisht të lulëzuar dikur. Sepse, vetëm pak vite pasi ishte rindërtuar, Ulpiana – ose Justiniana Secunda – në mënyrë misterioze u zhduk nga historia duke i lënë pas veç rrënojat që do t'i gjendeshin në vitin 1953.

Për shembull, historiani francez i përfshirë në gjetjen e mbishkrimeve të Justinianit, Christophe Goddard, tregon që Ulpiana e rindërtuar ishte dyfish më e vogël (19 hektarë) se që kishte qenë më parë (39 hektarë). Dhe madje, ishte rindërtuar jo bash aty ku kishte qenë por një kilometër më në lindje.

— Albin Kurti (@albinkurti) August 4, 2025

Është e vërtetë se ato që janë zbuluar – mbishkrime, statuja, gërmadha tjera – janë nga shtresa sunduese e Ulpianës pas rindërtimit të saj. Pra, nga ata skllavopronarë e tregtarë të pasur të periudhës së Justinianit që donin të linin diçka pas vetes. Dhe jo nga skllavët e fshatarët dardanë që preokupim të vetëm e kishin mbijetesën. Por, gjithçka që duket këtu është më ndryshe se që duket.

Ulpiana ishte larg më e madhe se Perandori Justinian (për ne shqiptarët).

Në qendër të Ulpianës rrënja Dardane, jo Justiniani

Ulpiana kishte marrë statusin “Municipium” ose “qytet i vetëqeverisur” 400 e më shumë vjet para rindërtimit që i bëri Justiniani. Dhe ekzistonte si vendbanim shumë përpara kësaj kohe – megjithëse, nuk dihet saktë data e lindjes së saj.

Para se të bëhej qendër episkopale me peshkop e me priftërinj e bazilika siç e kishte ndërtuar Justiniani, Ulpiana veçse kishte një traditë të gjatë si qytet dhe pati një bum të jashtëzakonshëm zhvillimi.

Meqë i kishte 40 hektarë, kjo nënkupton se me një dendësi mesatare Ulpiana i kishte diku prej 10 mijë deri në 12 mijë banorë. S'duhet harruar se po flasim për një periudhë kohore në të cilën numri total i banorëve në botë ishte 40 herë më pak se sot dhe numri i qyteteve ishte mijëra herë më i vogël.

Sa i përket piramidës shoqërore – asaj që dihet prej fillimit të shekullit II e deri në shekullin VI – duhet thënë se ajo ishte e krijuar nga Perandoria Romake por kishte edhe ndikimin lokal dardan.

Ta zëmë, skllavëria ishte normale. Por, kishte edhe plot fshatarë e punëtorë të lirë që vinin në Ulpianë për të bërë pazar ose për të marrë pjesë në festivale e për të paguar taksat. Kishte edhe zejtarë e tregtarë. Për shembull, disa ishin farkëtarë. Disa ishin gurëgdhendës. Disa tjerë poçarë. E kështu me radhë.

Ulpiana ishte e njohur edhe për minierat e saj. Kështu që, një pjesë e madhe e shoqërisë i takonte shtresës së minatorëve, metalpunuesve dhe tregtarëve të mineraleve.

E meqë e kishte një traditë të gjatë në vetëqeverisje lokale, kishte edhe plot administratorë e oficerë ushtrie. Por, duhet thënë se kishte edhe ushtarakë të lartë të Perandorisë Romake që dilnin në pension pasi merrnin toka nëpër qytete më provinciale.

Pra, Ulpiana kishte përjetu lloj-lloj dramash e intrigash politike, siç e kishte përjetu edhe një gjallëri të jashtëzakonshme për rrethanat e kohës.

Vetë emri Ulpianë besohet gjerësisht nga historianët se erdhi nga familja e famshme romake Ulpus. Ajo ishte një familje nga e cila rrodhi senatori dhe gjenerali romak Marcus Ulpus Traianus dhe më pas edhe Perandori i famshëm Trajani që parapriu një prej perandorëve më të mirë romakë, Hadrianin – e i cili gjithashtu kishte lidhje me familjen Ulpus.

Perandor Trajani besohet se në atë periudhë – për arsye strategjike – e kishte ndërmarrë një fushatë në Ballkan për t'i konsoliduar ato rajone si pjesë të Perandorisë Romake. Si komponentë e kësaj fushate ishte edhe zhvillimi i Ulpianës. E prandaj, edhe emri i familjes së tij u bë emri i qytetit.

Fatkeqësisht, nuk ka të dhëna të shkruara që tregojnë se çfarë emri kishte Ulpiana para vitit 100 dhe se në çfarë mënyre ekzistonte. Por, kjo nuk e mohon në asnjë formë rrënjën e saj dardane meqë shtrihej pikërisht në territoret që i përshkruhen Dardanisë nga gjeografët grek Strabo dhe Ptolemeu, historianët romakë Appiani i Aleksandrisë dhe Kassius Dio por edhe të tjerë.

Nëse në tregimin e Ulpianës e qendërzojmë figurën e Justinianit të Madh, atëherë ne rrezikojmë ta zhbëjmë krejtësisht historinë e saj. Kjo sepse Justiniani i Madh krijoi e rikrijoi edhe njëzet deri në tridhjetë qytete tjera.

Ulpiana është e jashtëzakonshme për shkak se u zhvillua e lulëzoi si një qytet dardan gjatë Perandorisë Romake, të paktën për katërqind vite prej 117 e deri më 518. Aty mund të jenë edhe rrënjët tona, si pasardhës të Dardanëve. Në tjetrën anë, rindërtimi i Ulpianës nga Justiniani fatkeqësisht ia zgjati jetën qytetit vetëm për disa vite.

Perandori Justinian ishte një perandor bizantin shumë autoritar që shtypte jo vetëm dardanët por edhe të gjithë popujt tjerë që i kishte nën sundim.

Sidoqoftë, lidhja më e fortë e Justinianit me Ulpianën merret rindërtimi që ai ia bëri qytetit. Për ata që s'e dinë: Ulpiana ishte shkatërru gati plotësisht prej një tërmeti të madh që kishte ndodhë në vitin 518, siç rrëfen edhe kronisti i asaj kohe Marcellinus Comes .

Nëntë vite më vonë, me t'u bërë Perandor, Justiniani e nisi një program masiv të rindërtimit nëpër Ballkan. Pra, jo vetëm në trojet dardane. Dhe s'ishte veprim nga dashamirësia e tij por nga nevoja që Perandoria të mbrohej nga sulmet e vazhdueshme të dakëve, e më vonë edhe Avarëve e Sllavëve. Dhe po flasim për një kohë kur Perandoria Romake veçse i kishte 50 vjet që kishte rënë ndërsa Perandoria Bizantine po hynte në një fazë njëmijë-vjeçare të përgjumjes.

Historiani i asaj kohe, Procopiusi, kishte tregu për rindërtimin e Ulpianës dhe emërtimin e saj nga Justiniani si Iustiniana Secunda. Ose, Justiniana e Dytë.

Ndërkohë, Justiniana Prima, pra Justiniana e Parë ndodhet në Serbi. Ky qytet ishte ndërtu po ashtu nga Justiniani prej fillimit më 535. Qysh në këtë emërtim, e vërejmë që Justinianit s'i bënte fort për Dardaninë e për Ulpianën e më-the-e-të-thashë.

Mbishkrimet e gjetura në dy vitet e fundit – e që u bënë edhe lajm ndërkombëtar – e lidhin direkt Perandorin Justinian dhe gruan e tij, Teodorën, me qytetin e Ulpianës. Janë bërë nga vetë Perandori Justinian. Sidoqoftë, po flasim thjesht dhe vetëm për disa vite ekzistencë të një qyteti të lashtë e jashtëzakonisht të lulëzuar dikur. Sepse, vetëm pak vite pasi ishte rindërtuar, Ulpiana – ose Justiniana Secunda – në mënyrë misterioze u zhduk nga historia duke i lënë pas veç rrënojat që do t'i gjendeshin në vitin 1953.

Për shembull, historiani francez i përfshirë në gjetjen e mbishkrimeve të Justinianit, Christophe Goddard, tregon që Ulpiana e rindërtuar ishte dyfish më e vogël (19 hektarë) se që kishte qenë më parë (39 hektarë). Dhe madje, ishte rindërtuar jo bash aty ku kishte qenë por një kilometër më në lindje.

Është e vërtetë se ato që janë zbuluar – mbishkrime, statuja, gërmadha tjera – janë nga shtresa sunduese e Ulpianës pas rindërtimit të saj. Pra, nga ata skllavopronarë e tregtarë të pasur të periudhës së Justinianit që donin të linin diçka pas vetes. Dhe jo nga skllavët e fshatarët dardanë që preokupim të vetëm e kishin mbijetesën. Por, gjithçka që duket këtu është më ndryshe se që duket.



FËMIJËT NË HARDH FEST: MIDIS PËRGJEGJËSISË SË MUNGUAR DHE DHUNËS SË HESHTUR KULTURORE

12 Shtator, 2025 - 18:11

tjeter.net/femijet-ne-hardh-fest-midis-pergjegjesise-se-munguar-dhe-dhunes-se-heshtur-kulturore/

Hardh Fest është një festival me rëndësi kulturore dhe turistike në Kosovë, që me vite të tëra ka afirmuar Rahovecin si kryeqendër të vreshtarisë dhe verës. Por, në të njëjtën kohë, ky festival ka nxjerrë në pah edhe një problem që shpesh fshihet pas euforisë kolektive: prania e fëmijëve në hapësira ku dominon muzika e zhurmshme, konsumimi i alkoolit dhe atmosfera e të rriturve deri në orët e vona të natës.

Pjesëmarrja e fëmijëve nën moshën 16 vjeçare, madje edhe fëmijë 2–3 vjeçar të cilët shihen në krahët e prindërve të tyre nga ora 20:00 e deri pas mesnate, në vend se të ishin në shtretërit e tyre dhe ne gjumë, janë shembulli më i qartë i një shkeljeje të ritmit natyror. Në filozofinë antike, Aristoteli e shihte jetën e mirë si përputhje me natyrën, kurse këtu është e kundërta, kemi të bëjmë me një dëmtim të harmonisë natyrore.

Por në këtë pikë ngrihet pyetja: a e kanë trajtuar ndonjëherë organizatorët e Hardh Fest-it çështjen e pranisë së fëmijëve të vegjël në një ambient që nuk është i krijuar për ta? A është marrë ndonjë masë për të mbrojtur ritmin biologjik të tyre, apo prania e tyre thjesht është toleruar si “normale” dhe iu është besuar prindërve që të jenë përgjegjës.

Ekspozimi i fëmijëve ndaj një realiteti që nuk i takon moshës së tyre krijon një formë dhune simbolike – dhunë që lë gjurmë të dukshme, dhe që deformon përvojën e tyre të hershme me botën.

Normalizimi i alkoolit dhe dhuna kulturore

Një nga aspektet e dëmshme të kësaj pranie është ekspozimi i fëmijëve ndaj normalizimit të alkoolit. Në një festival të tillë, vera dhe pijet janë jo vetëm pjesë e ofertës gastronomike, por edhe simbol qendror i festës. Për të rriturit, kjo është traditë, ndërsa për fëmijët është përballja e parë me një kulturë ku alkooli perceptohet si kusht i gëzimit dhe i shoqërimit.

Filozofi francez Pierre Bourdieu do ta quante këtë një formë dhune kulturore, në të cilën norma e të rriturve shndërrohet në standard edhe për fëmijët. Ata mësohen herët të pranojnë se gota e ngritur është simbol i gëzimit, dhe jo një element i diskutueshëm. Por, a ka pasur ndonjë reagim nga profesionistë të shëndetit mendor apo nga ndonjë organizatë qoftë joqeveritare apo qeveritare, dhe këtu më nuk e kemi fjalon vetëm për Hardh Fest-in, por edhe për festivale të ngjashme, ku prania e fëmijëve është më se e zakonshme. Ky fenomen kalon edhe përtej festivaleve, e hasim edhe në përditshmëri, çdo ditë shohim të mitur të cilët blejnë cigare, apo edhe alkool në markete, pavarësisht se ato janë për prindërit e tyre. Megjithatë, kjo konsiderohet e dëmshme sepse e perceptojnë si normale blerjen dhe pirjen e duhanit dhe alkoolit për prindërit e tyre. Këto ekspozime të hershme krijojnë një terren të favorshëm për internalizimin e ideve që, më vonë në adoleshencë, mund të çojnë në rritjen e konsumimit të këtyre produkteve dhe krijimin e varësisë nga to.

Përgjegjësia e munguar: prindërit dhe organizatorët

A do të duhej të trajtoheshin fëmijët si mjet për kënaqësinë e prindërve? Çdo akt i prindit që zgjedh të qëndrojë në festival në vend që të sigurojë gjumin e qetë të fëmijës së tij është një akt i mungesës së përgjegjësisë.

Por përgjegjësia nuk është vetëm individuale. Organizatorët e festivalit, të cilët kanë krijuar një hapësirë publike për argëtim, duhet të vendosin kufij etikë dhe praktikë. Ashtu siç ka rregulla sigurie për skenën, dritat dhe emergjencat, duhet të ketë edhe një rregull të qartë: ndalim të pjesëmarrjes të paktën për fëmijët nën 16 vjeç.

Pasoja shoqërore

Një shoqëri që nuk i mbron fëmijët, por i shndërron ata në një pjesëmarrje pasive në ritualet e të rriturve, është një shoqëri që rrezikon të prodhojë gjenerata me kufij të turbulluar mes botës së fëmijërisë dhe asaj të rriturve. Në vend që të krijojë hapësira të veçanta për fëmijët, ajo i hedh ata në botën e zhurmës dhe konsumit.

Por atëherë, a mund të konsiderohet ky fenomen si një formë e dhunës së heshtur kulturore, ku fëmijët shndërrohen në dekor të botës së të rriturve? Nëse po, atëherë kemi të bëjmë me një çështje më të thellë se sa duket – një krizë e vetëdijes kolektive.

Hardh Fest, me gjithë rëndësinë e tij kulturore dhe ekonomike, nuk duhet të lejojë që euforia e turmës të mbulojë të drejtën e fëmijëve për qetësi dhe siguri. Organizatorët duhet të marrin guximin për të vendosur rregulla të qarta, ndërsa prindërit duhet të kuptojnë se pjesëmarrja e tyre në festë nuk ka vlerë nëse bëhet mbi llogarinë e shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve.

Fëmijët nuk duhet të jenë dekor në festën e të rriturve, është një fazë e shenjtë e jetës, që meriton të mbrohet nga çdo formë ekspozimi e cila konsiderohet e parakohshme ndaj botës së alkoolit, zhurmës dhe konsumit të tepruar.



**KRIJIMET
EKSTREME DHE
TURBULLUESE TË
LÁSZLÓ
KRASZNAHORKAI,
FITUESIT TË
NOBELIT 2025**

9 Tetor, 2025 - 16:16

tjeter.net/krijimet-ekstreme-dhe-turbulluese-te-laszlo-krasznahorkai-fituesit-te-nobelit-2025/

Shkrimtari László Krasznahorkai ka fituar çmimin Nobel për Letërsi për vitin 2025. Ne po iu sjellim të përkthyer me shkurtime këtë artikull të botuar nga The New Yorker të shkruar nga James Wood.

“Realitet që ekzaminohet deri në pikën e marrëzisë.” Qysh do të dukej kjo në shkrimet bashkohëse? Mund të duket diqysh si në fiksionin e László Krasznahorkait – shkrimtarit hungarez të zorshëm, të veçantë, obsesiv e vizionar me plot e pëplot vepra, por që vetëm dy iu përkthyen në anglisht.

Fjalitë e tij të palodhshme por lodhëse – një e vetme mundet me e përfundu një kapitull të tërë – duken të pafundme, dhe na shfaqen pa ndarje mes paragrafësh.

Shpesh është e vështirë të kuptohet se çka mendojnë personazhet e Krasznahorkait sepse bota e tij trillore tundet kah një zbulim i madh që s’vjen që s’vjen. Te “Lufta dhe Lufta,” Gyorgy Korin, arkivist e historian lokal nga një qytezë hungareze, është në çmendje e sipër. Përgjatë krejt novelës, ai rri “te dera e një perceptimi vendimtar,” por kurrnjëherë s’kallëzon se çka është ai perceptim.

Qe një citim i gjatë nga ky libër:

“sepse s’i vinte të kthehej në banesën e zbrazët për ditëlindje, dhe përnjëmend veç kur ndodhi, veç kur e kapi, perëndi e lume, ai s’po merrte vesh asgjë, që ishte me kuptu diçka të tmerrshme, tha ai, sidomos në mënyrën qysh i ndodhi me krejt atë banalitet, vulgaritet, dhe në një shkallë aq qesharake sa të sëmurte, ama kjo ishte poenta, tha ai, mënyra qysh ai, në moshën katërdhjetë-e-katër-vjeçare, e kishte marrë vesh se çfarë budallai i dukej vetes, sa boshe, sa kokëtrashë kishte qenë në të kuptuarit e botës këto katërdhjetë-e-katër vjet,, sepse, siç e kuptoi ndanë lumit, jo që s’e kishte kuptu botën, por s’kishte kuptu kurrgjë për kurrgjë hiç, dhe më e keqja ishte se për katërdhjetë-e-katër vjet ai kishte mendu se e kishte kuptu, e në realitet s’kishte qenë ashtu; dhe kjo në fakt ishte gjëja më e keqe atë natë ditëlindjeje kur u ul ndanë lumit, më e keqja sepse fakti që tash po e merrte vesh që s’e kishte kuptu nuk nënkuptonte se po e kuptonte, sepse me qenë i vetëdijshëm për mungesën e njohjes s’Ishte në vetëvete ndonjë formë e re e njohjes që do ta zëvendësonte të mëparshmen, por e tillë që e shfaqte veten si një enigmë tmerruese në momentin që mendoi për botën, siç mendoi i tërbuar atë natë, duke e torturuar veten për me kuptu dhe duke dështu, sepse enigma dukej gjithnjë e më komplekse dhe ai nisi me mendu qysh kjo botë-enigmë që donte me kuptu, që po e torturonte veten duke provu me kuptu, ishte në fakt një enigmë për veten dhe botën njëkohësisht, që ata ishin në realitet një gjë e vetme, e ky ishte konkluzioni ku kishte mbërrir deri tash, por s’ishte dorëzuar ende, kur pas nja dy ditësh, ai vërejt se kishte diçka që s’shkonte me kokën e tij.”

Ky pasazh na i shfaq shumë prej cilësive të Krasznahorkait: vazhdimësinë e palodhshme të sintaksës; mënyrën qysh i shtrihej mendja personazhit Korin dhe më pas i kthehej mbrapsht, si një akrep i marrë që provon me thumbu veten; vendosja e përsëtosur komike e frazës së fundit. Proza e ka një farë përzierje vetëkorrigjuese, sikur diçka përnjëmend po ndodhte, e megjithatë, këto korrigjime kurrë s’rezultojnë në përgjigjen korrekte.

Te “Lufta dhe Lufta” – epigrafi i së cilës është “Parajsa është e trishtë” – Korini e gjen një dorëshkrim në arkivën ku punonte. E mori tekstin, që dukej se datonte nga vitet 1940 – në një kuti me etiketën “Letra familjare pa ndonjë rëndësi të veçantë.” Ky tekst është një narracion fikcional për katër burra, të quajtur Kasser, Falke, Bengazza dhe Toot, që i kanë disa aventura, prej Krete në Koln e në veri të Anglisë, dhe në periudha të ndryshme historike. Korini trulloset prej bukurisë së këtij dorëshkrimi të panjohur; momenti kur e kap nga kutia, “jeta i ndryshon përgjithmonë”. Veçse në gjendje jostabile, ai vendos që dorëshkrimi ka një përgjigje religjioze apo vizionare për “enigmën” e jetës së tij. Ai është i sigurt se përnjëmend teksti flet për “Kopshtin e Edenit” dhe vendos që me shku në atë që e sheh si “qendrën e botës, në një vend ku gjërat përnjëmend ka vlerë, ku gjërat ndodhin, në një vend si Roma e dikurshme, antike, ku vendimet merren dhe ngjarjet ngjajnë, për me gjetë atë vend dhe me lënë pas gjithçka.” Ai vendos që ky vend është Nju Jorku. Aty do ta publikojë dorëshkrimin duke e postuar në Internet. Dhe, mendon ai, atëherë jetës së tij do t’i vijë fundi.

László Krasznahorkai ka lindur në Gyula, në juglindje të Hungarisë, më 1954. Ai ka jetuar edhe në Gjermani edhe në Amerikë, por emri i tij është më i njohur në Evropë. Ai njihet më së shumti për bashkëpunimin që ka pasur me regjistorin Bela Tarr, i cili veprat e tij i ka bërë filma.

Te Krasznahorkai shpesh s’ia kemi idenë se çka i motivon trillet e tij. Ta lexosh atë është sikur të shohosh një grup njerëzish të mbledhur në rreth në një shesh, duke i ngrohur duart pranë zjarrit, vetëm për ta kuptuar, derisa i afrohem, se nuk ka zjarr, dhe se janë mbledhur rreth kurrgjëje hiç.

Te “Lufta dhe Lufta”, Korini udhëton për Nju York, strehohet me një përkthyes hungarez, z. Sarvary, e merr një kompiuter dhe fillon të shtypë tekstin e këtij dorëshkrimi jashtëzakonisht të rëndësishëm. Por, dëshpërimi i lidhjes së tij me tekstin barazvlerësohet me pamundësinë e tij që ta përshkruajë rëndësinë e vërtetë të tij:

“Qysh në tri fjalitë e para ai u bind se po lexonte diçka të jashtëzakonshme, diçka aq larg të zakonshmes, e informoi Korini z. Sarvary, sa do të mund të thoshte bile edhe se, kjo vepër që ndodhej në posedimin e tij, ishte vepër e një gjenialiteti kozmik që dridhte themelet e gjithçkaje, dhe duke e menduar këtë gjë, ai vazhdoi të lexonte e rilexonte fjalitë deri në mëngjes, dhe sapo doli dielli u bë natë prapë, rreth orës gjashtë në mbrëmje, dhe ai e dinte, absolutisht e dinte, që duhej të bënte diçka në lidhje për krejt ato mendime të pafundme që i formoheshin në krye, mendime që kishin të bënin me vendime të mëdha për jetë a vdekje, për të mos kthyer dorëshkrimin në arkivë por që të sigurohej në pavdekshmërinë e tij në një vend të duhur-. se ai duhej ta bënte këtë dije bazën e jetës që i kishte mbetur, dhe z. Sarvary duhej ta kuptonte që kjo duhej të kuptohej në sensin më strikt të mundshëm, sepse kur të agonte ai do të kishte vendosur që, marrë parasysh faktin se donte të vdiste ashtu-kështu, dhe që ai e zateti rastësisht të vërtetën, s’kishte çka të bëhej tjetër përpos- në sensin më strikt të mundshëm, ta bazonte jetën në pavdekshmëri.”


Jo vetëm që kjo e vërtetë që e zatet Korini nuk definohet; por po ashtu vet Krasznahorkai e ndalon Korinin. Pasazhi i mësipërm është përshkrim në veten e tretë, por vërejeni se në çfarë forme të çuditshme e jostabile që e devijon nga raportimi i një aktiviteti që po ndodhë (“vazhdoi me lexu e rilexu fjali deri në mëngjes”), përshkrimi i një gjendjeje mendore (“duhej të bënte diçka për ato mendime të pafundme që i formoheshin në krye”) dhe një raportim i një monologu të pandalshëm që Korini duket se po i jep z. Savary (“diçka aq larg të zakonshmes, Korini e informoi z. Savary”). I gjithë ky pasazh, edhe në ato elemente që duket se gjejnë mbështetje në fakte objektive, ka cilësorin e halucinimit. Kuptohet që Korini e kalon kohën ose duke folur si maniak me njerëz tjerë ose duke folur si maniak me veten, dhe se ndoshta s’ka fort rëndësi mes këtyre dyjave. Gati secila faqe të “Lufta dhe Lufta” përmban frazën “tha Korini” apo ndonjë variacion të saj. Kjo është një parodi e atribuimit të burimit që e gjejmë nëpër gazeta, qëllimi i të cilave është që të vihet në dyshim autoriteti gazetaresk. Në një moment të “Lufta dhe Lufta” , ne e hasim këtë konfuzion sublim: “Më beso kur ta them, siç e kam thënë më herët, tha ai, se krejt kjo gjë është e palexueshme, çmenduri!!!”

Në Nju Jork, Korini fillon që t’i tregojë z. Savary, dhe më pas partneres së tij, për dorëshkrimin. Ditë pas dite, ai ulet në kuzhinë, dhe i ritregon rrëfimet për Kasserin, Falken, Bengazzan dhe Tootin. Krasznahorkai riprodhon këto trille të bukura – ka pasazhe të jashtëzakonshme për Katedralen e Kolnit dhe Murin e Hadrianit. Korini i rrëfen partneres së Sarvaryt se, derisa lexon dorëshkrimin dhe e shtypë atë në kompiuter, ai mund “të shohë” këto karaktere, sepse teksti ka fuqi mrekullibërëse. Dhe ngadalë-dalë, lexuesi e zbulon atë që e ka dyshu prej fillimit, që Korini s’ka gjetë kurrfarë dorëshkrimi por që po e shkruan të vetin në Nju Jork; që “dorëshkrimi” është një trill mendor, një vizion transcedent i një të çmenduri. Etiketa “tha Korini” paevitueshëm rrëshqet në “ shkroi Korini.” Të lexosh, të thuash, të shkruash, të mendosh dhe të shpikësh pësjtjellohen keq në mendjen e Korinit, dhe pashmangshëm se pësjtjellohen edhe në mendjen e lexuesit.

Mu për këto arsye, kjo është një prej përvojave më turbulluese që kam pasur si lexues. Deri në fund të novelës, ndihesha sikur i isha afruar të banuarit brenda mendjes së një njeriu tjetër aq sa letërsia mund të ma lejonte një gjë të tillë, dhe në veçanti banimit të një mendjeje të “lufta dhe lufta” – mendje jo pa vizione bukurie por po ashtu krejt e humbur në trillet e saj të pakomunikueshme, në dhimbën qesharakisht pjellore (“Parajsa është e trishtë”). Kjo dhimbje është e mbishkruar te “Lufta dhe Lufta” ashtu siç Korini ndihet se dhimbta përshkruhet në faqet e dorëshkrimit të tij:

“Dorëshkrimi e kishte një interes të vetëm, dhe ai ishte që realiteti të ekzaminohej deri në pikën e marrëzisë, dhe përjetimi i krejt imtësirave intenzivisht të çmendura, gravurat nga përsëritjet maniake të lëndës në imagjinatë, ishin, dhe e besonte këtë gjë fjalëpërfjalshëm, shpjegonte Korini, sikur shkrimtari të kishte shkruar tekstin jo me laps e me fjalë por me thonjtë e tij, duke e gërvishtër letrën në letër dhe në mendje.”

Lexo tekstin e plotë në anglisht duke klikuar [KËTU](#) .



**FILMI “ERA”:
SHIKUESI
TORTUROHET SI
NJË I BURGOSUR
NË GUANTANAMO**

21 Tetor, 2025 - 00:30

tjeter.net/filmi-era-shikuesi-torturohet-si-nje-i-burgosur-ne-guantanamo/

Që në dhjetë minutat e parë të filmit “Era” më kapi një marramendje. Jo nga ideja a nga tregimi. Por, nga pamja. Gjithçka ishte aq e mjegullt sa më duhej të kapesha për karrige për të mos rënë. Kur filmi u krye isha i dërrmuar. S’e dija se a po dilja prej një dhome torture apo prej një kinemaje.

Pamja ishte përnjëmend një katastrofë estetike. Regjisorja duke dashur të na kthente në Prishtinë e viteve ’90 i kishte fshehur elementet e kudondodhura të Prishtinës së sotme. Por përpjekja për fshehje të kësaj Prishtine ishte aq enorme, mbikoncentrimi në këtë fshehje ishte aq i madh, sa po kryhej efekti i kundërt. Kjo Prishtina jonë moderne, e gërditshme, e neontë, hiperkonsumerike dilte sheshit bash sepse fshehja të thoshte “kujtohu çfarë pamje po turbulloj”.

Pamja ishte aq e shkarravitur sa dukej më shumë si një film vizatimor me surratë njerëzish që notonin nëpër një asgjë të madhe. Pikërisht këto surratë fokusoheshin aq shumë sa s’kishte kuptim. Kamera u var pas tyre si një qen i uritur. Dhe, kur e sheh për 90 minuta, kjo të çon në një farë monotonie të pabesueshme emocionale.

Po merrem me këtë problem sepse është tepër elementar. Filmi është pamje. Në kinema ke përpara një mur gjigant me imazh. 30-40 metra gjatësi dhe 20-30 metra lartësi. Dhe kur ai imazh i madh është i mjegullt për 90 minuta, atëherë truri yt sfilitet duke u përpjekë që t’i japë kuptim. Por, edhe pse sfilitet ai provon pa rreshtë. Kështu që pastaj të kapë marramendja dhe të topiten ndjesitë.

Të merremi tash me atë që e tregonin pamjet e stërfokusuara. | Prej këtu ka ‘spoilers’. |

Era Gashi – e luajtur mirë nga Zana Berisha – është një nxënëse e shkollës së mesme me një karakter paksa rebel që thyhet e përthyeret e stërthyeret nga mundimet e fillimit të viteve ’90 në Prishtinë. Së pari, ajo paragjykohet dhe fyhet për lidhjen e dashurisë me një djalë serbo-shqiptar. Më pas, babain ia largojnë nga puna ashtu si shumicën e kosovarëve në atë kohë, që i detyron të largohen nga banesa në Prishtinë në pamundësi për me pagu kredinë. Shkojnë në fshat te gjyshja. Për Erën kjo është veçanërisht e rëndë sepse përbën ndarje prej jetës që e bënte në Prishtinë. Ta zëmë, edhe pse ende e mitur (ishte ende në shkollë të mesme) ajo pi cigare, merr bari (marihuanë), shkon nëpër lokale të natës dhe ka liri të madhe erotike për kohën.

E gjithë ngjarja e mëpastajme është një vallëzim nëpër rrethana historike të rënda për Kosovën tonë. Apartheid. Shtëpi të kthyera në shkolla. Varfëri e skajshme. Emigracion i detyruar nga Serbia dhe nga ajo varfëri e skajshme. Zatatje kurdoherë e dhunshme me shtetin.

Era e gjen veten të rrënuar poshtë rrënojave gjigante të një ngrehine sociale të shembur. Kërkon lirinë erotike të saj në një kohë që s’i jep as lirinë për me marrë frymë lirshëm.

Një gjë tjetër interesante është ta shohësh Erën derisa thyhet, ngrihet, thyhet sërish e ringrihet sërish. Por, sa herë që ngrihet është duket më e mundur dhe më e humbur (ta zëmë, e pranon martesën me një komshi në fshat kur e sheh që s’ka kah ia mbanë).

Dhe në fund është Alban Ukaj. Ai është personazhi më interesant dhe më i zhvilluar i këtij filmi. Loja e tij është aq e mirë sa pothuajse ia vlen krejt ajo mjegull?! Jo, s’ia vlen. Ai është protagonist edhe i skenës më domethënëse dhe emocionale të këtij filmi. I thotë Erës, vajzës së tij në film, se kishte dështuar që ta mbronte kur ajo i tregon se pranoi të martohej me komshiun. Po i thoshte me fjalë tjera, se dështoi t’ia mbronte lirinë.

Gjëja më e bukur (të paktën, për mua si kosovar) është gjuha. Ajo është e gjallë. Pa gramatikë sterile, pa standardizim të kotë dialekti. Ashtu siç e flasim dhe siç e njohim. E rrëmujshme dhe e çrregullt. Por që i dha një farë vule të fortë autenticiteti.

Shkoni e shikojeni. Por, jo nëse keni probleme të caktuara shëndetësore (s'po bëj shaka).